

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE “UEJL” FAKULTETI JURIDIK
STUDIME POSTDIPLOMIKE – MASTER DREJTIMI CIVIL



PUNIM DIPLOME

**INSTITUTI I ADOPTIMIT ME FOKUS NË LEGJISLACIONIN E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Kandidat :

Arta Beluli

Mentor :

Doc. Dr. Albana Metaj-Stojanova

Tetovë, Tetor 2022

Deklaratë e autorësisë

Unë, Arta Beluli, e lindur më 10 shtator 1998 në Kumanovë, studente në Universitetin e Evropës Juglindore me ID 127096, në Fakultetin juridik në programin master E Drejta Civile, vërtetoj se unë jam autor origjinal i punimit “**Instituti i adoptimit me fokus në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut**”. Sipas njohurisë time punimi nuk përmban asnjë material të botuar nga dikush tjetër përpos burimeve që janë të cituara në mënyrë të rregullt dhe të cilat janë vënë dukshëm në tekst. Universitetit i barten të drejtat autoriale të punimit, për përdorim për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Abstrakt

Objekt studimi i këtij punimi me temë “Instituti i adoptimit me fokus në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut” është adoptimi i fëmijëve sipas legjislacionit të RMV-së. Gjithashtu objekti i këtij punimi ka të bëjë me sqarimin e rëndësisë së adoptimit në shoqëri. Si dhe me zhvillimin historik të këtij instituti. Pavarësisht faktit që ligji urdhëron çdo prind dhe familje që të përkujdeset për fëmijët , numri i fëmijëve të braktisur është i shumtë dhe në këto raste vjen në shprehje instituti i adoptimit, ku përmes këtij instituti fëmija do të gjejë mbështetje familjare dhe prindërore. Po ashtu edhe adoptuesit do të krijojnë marrëdhënie prind dhe fëmijë.

Në këtë punim do sqarohen në detaje kushtet që duhet të plotësohen për të qenë adoptues si dhe kushtet që duhen plotësuar për të qenë i adoptuar, po ashtu sic u theksua dhe më lart se do të sqarohet zhvillimi historik i adoptimit. Ky punim në detaje tregon adoptimin në të drejtën romake, po ashtu edhe adoptimin në islam. Si dhe zhvillimin historik të adoptimit në Maqedoninë e Veriut. Në këtë punim do të theksohen të gjitha llojet e adoptimit dhe do të numërohen kushtet të cilat janë thelbësore për themelimin e adoptimit. Po ashtu ky punim përfshin aspektet krahasuese të adoptimit me shtetet e rajonit, domethënë bën krahasimin e legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë sa i përket institutit të adoptimit. Në mënyrë të përpiktë punimi sqaron procedurën e adoptimit, efektet e këtij instituti, si dhe themelimin dhe shuarjen e tij. Në këtë punim do të përfshihen edhe të dhëna statistikore mbi adoptimin e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky hulumtim ka për qëllim analizën e adoptimit, fëmijëve të braktisur të cilët bëhen pjesë e adoptimit vendor dhe të shteteve të rajonit, statistikave të adoptimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Një hulumtim i tillë është mjaft me rëndësi dhe ia vlen për të pasur njohuri për këtë institut sepse jeta e ditëve të sotme mos ndjenja e dhembshurisë ndaj fëmijëve, ftohja e njerëzve në përgjithësi çon deri në rritjen e madhe të nivelit të fëmijëve të braktisur, për të cilët adoptimi do të jetë e vetmja formë e strehimit dhe mënyra e vetme për t’u dhënë dashuri pa kushte.

Fjalët kyçe: *adoptim, adoptues, prind, fëmijë, i adoptuar.*

Abstract

The object of study of this thesis on the topic "Institute of adoption with a focus on the legislation of the Republic of North Macedonia" is the adoption of children according to the legislation of the Republic of North Macedonia. Also, the object of this thesis is about clarifying the importance of adoption in society. As well as with the historical development of this institute. Despite the fact that the law orders every parent and family to take care of children, the number of abandoned children is large and in these cases the adoption institute comes into play, where through this institute the child will find family and parental support. Adopters will also create parent-child relationships.

In this thesis, the conditions that must be met to be an adopter, as well as the conditions that must be met to be adopted, will be explained in detail. Also, as was emphasized above, the historical development of adoption will also be clarified. This thesis shows in detail the adoption in Roman law, and the adoption in Islam. As well as the historical development of adoption in North Macedonia. In this thesis, all types of adoption will be highlighted and the conditions that are essential for establishing adoption will be enumerated. This thesis also includes the comparative aspects of adoption with the countries of the region, that is it compares the legislation of North Macedonia, Kosovo, and Albania regarding the institution of adoption. In a precise way, the thesis explains the procedure of adoption, the effects of this institute, its establishment and extinction. Statistical data on the adoption of children in North Macedonia will also be included in this thesis.

This research is aimed at the analysis of adoption, abandoned children who become part of local adoption and regional states, adoption statistics in North Macedonia. Such research is very important and worth knowing about this institute because today's life, the lack of compassion for children, leads to a large increase in the level of abandoned children, for whom adoption will be the only form of shelter and the only way to give them unconditional love.

Key words: *adoption, adopter, parent, child, adopted.*

Përmbajtja

Deklaratë e autorësisë.....	2
Abstrakt	3
Abstract.....	4
Hyrje	7
KAPITULLI I	9
1. Kuptimi,rëndësia dhe zhvillimi historik i adoptimit.....	9
1.1 Kuptimi i adoptimit	9
1.2 Rëndësia e adoptimit në shoqëri.....	11
1.3 Adoptimi në të drejtën romake.....	12
1.3.1Filii familias me anë të adrogatio.....	13
1.3.2Filii familias me anë të adoptio.....	15
1.3.3Gjendja juridike e filii familias.....	16
1.3.4 Ndërprerja e statusit të filii familias.....	18
1.4 Adoptimi në islam.....	19
1.4.1 Instituti islamik i kafalas.....	20
1.5 Zhvillimi historik i adoptimit në Maqedoninë e Veriut.....	22
KAPITULLI II	25
2. Rregullimi juridik i adoptimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	25
2.1 Kuptimi dhe llojet e adoptimit.....	25
2.2 Kushtet thelbësore për themelimin e adoptimit.....	27
2.3 Kushtet për vlefshmërinë e adoptimit.....	28
2.3.1 I adoptuari.....	28
2.3.2Adoptuesi.....	30
2.4 Kushti i përbashkët për të adoptuarin dhe adoptuesin.....	35
2.5 Pëlqimi i prindërve të fëmijës që adoptohet dhe pëlqimi i të adoptuarit.....	35
2.6 E drejta që të dihet prejardhja e fëmijës.....	37

KAPITULLI III	38
3. Procedura dhe efektet e adoptimit.....	38
3.1 Komisioni për themelimin e adoptimit.....	38
3.2 Procedura e adoptimit.....	40
3.3 Periudha provuese paraadoptuese.....	42
3.4 Themelimi i adoptimit.....	43
3.5 Efektet juridike të adoptimit.....	44
3.5.1 Mbiemri i të adoptuarit.....	44
3.5.2 E drejta për të trashëguar e të adoptuarit.....	45
3.6 Shuarja e adoptimit.....	45
3.7 Të dhëna statistikore mbi adoptimin e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut....	46
KAPITULLI IV	50
4. Aspektet krahasuese të adoptimit mes disa shteteve të rajonit.....	50
4.1 Birësimi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.....	50
4.1.1 Kuptimi dhe kushtet për birësim.....	51
4.1.2 Procedura administrative dhe gjyqësore e birësimit.....	53
4.1.3 Efektet juridike të birësimit.....	59
4.2 Adoptimi sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës.....	60
4.2.1 Kushtet për adoptim.....	61
4.2.2 Procedura gjyqësore e adoptimit.....	63
4.2.3 Efektet juridike të adoptimit.....	66
4.3 Konventa e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit.....	67
4.4 Konventa Evropiane për adoptimin e fëmijëve.....	69
Përfundimi.....	72
Rekomandime.....	74
Bibliografia.....	75

Hyrje

Punimi “ Instituti i adoptimit me fokus në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut” objekt studimi kryesor ka adoptimin e fëmijëve sipas legjislacionit vendas dhe aspektet krahasuese me shtetet e rajonit të Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo temë trajton çështje shumë të rëndësishme , në esencën e saj është një temë shumë e prekshme, sepse bëhet fjalë për fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore , do të trajtohet çështja se a është në nivel të duhur zbatimi i dispozitave ligjore sa i përket respektimit të të drejtave të këtyre fëmijëve në disa shtete por fokusi qëndron në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut. Në këtë punim do të analizohen mënyrat e adoptimit , cilat persona mund të jenë adoptues dhe cilët të adoptuar cilat kushte duhen plotësuar , çfarë mardhëniesh duhet krijuar mes adoptuesit dhe fëmijës , a duhet fëmija që në një moshë të caktuar të jetë i informuar që është i adoptuar , në cilën moshë duhet bërë kjo gjë dhe të gjitha detajet do të trajtohen veç e veç. Poashtu ky punim lidhet edhe me aspektin historik sa i përket ngecjeve dhe të arriturave të procedurave të adoptimit.

Adoptimi është një institut i rëndësishëm i të drejtës familjare i cili mes adoptuesit dhe të adoptuarit krijon të njejtat raporte ligjore sikur raportet mes prindërve dhe fëmijëve. Instituti i adoptimit si qëllim kryesor ka që fëmijës i cili është i privuar dhe nuk ka përkujdesje prindërore ti jepet mundësia që të bëhet pjesë e një familje adoptuese në mënyrë të përherëshme. Kjo familje nuk është familje biologjike e fëmijës por ai do të rritet dhe edukohet në këtë familje sikur të ishte fëmijë biologjik i adoptuesve.¹ Ndërkaq adoptimi në të drejtën romake i fëmisë së huaj alieni iuris bëhej shumë shpesh, domethënë fëmiju kalonte nga familja e deri tanishme tek familja e re nën pushtetin e pater familias. Këtu adoptimi nuk ka patur për qëllim kryesor interesin më të lartë të fëmisë por është bërë për shkak vazhdimit të kultit familjar domethënë qytetarët të cilët nuk kishin fëmijë për shkak të vazhdimsisë së familjes dhe kultit familjarë merrnin fëmijë dhe i përvetësonin nga shtresat e varfëra dhe nga të afërmit e tyre.²

¹ Arta Mandro , E drejta familjare , Tiranë , 2009 , fq.21,462

² Asllan Bilalli , Bedri Bahtiri, E drejta Romake, Prishtinë ,2015 , fq. 194,195

Qëllimi i këtij hulumtimi është kryerja e analizës të çështjes së adoptimit të fëmijëve në nivel vendor dhe, rajonal pasi braktisja e fëmijëve dhe njëkohësisht adoptimi i disa prej tyre është mjaft i përhapur, por nuk është trajtuar mjaftueshëm as në nivelin vendor e as në atë rajonal.

Gjithashtu qëllim tjetër i këtij punimi është paraqitja e rekomandimeve për aplikimin e institutit të adoptimit si formë më e përshtatshme për fëmijët pa prindër dhe përkujdesje prindërore dhe domosdoshmëria për përpilim të ligjeve sa i përket kësaj fushe . Në këtë punim do të shtrohen disa pyetje kërkimore të cilave do të përpiqemi t'u përgjigjemi në mënyrë të përpiktë:

- A paraqitet instituti i adoptimit si formë juridike më e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore?
- Sa është i pranishëm adoptimi në vendin tonë?
- Cilat kushte duhen plotësuar për të qenë adoptues?
- A merret parasysh interesi më i lartë i fëmijës gjatë adoptimit të tij ?
- A ekziston nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit mbi familjen sa i përket adoptimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore?

Në këtë studim do të përdorim metoda relevante për trajtimin e problematikës në fokus që lidhet me institutin e adoptimit fokusuar në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për të qenë sa më të qartë për rolin , vendin dhe rëndësinë e institutit të adoptimit në RMV dhe vendet tjera do të përdoret metoda e krahasimit, e cila gjithashtu do të na ndihmojë për të identifikuar elementet e përbashkëta dhe ato dalluese të institutit të adoptimit në disa vende të rajonit. Metoda e analizës ligjore, e cila do të përdoret gjatë shqyrtimit në aspekt krahasues të normave të këtij instituti, duke filluar nga aktet normative më të hershme e deri tek legjislacioni aktual do të na ndihmojë për të nxjerrë qartë në pah ndryshimet që kanë ndodhur me brendinë e institutit të adoptimit të fëmijëve. Poashtu edhe metoda historike konsiston në sqarimin evolucionit të këtij instituti nga vitet e mëhershme e deri më sot për të vënë në pah mënyrën e zhvillimit të këtij instituti, progresin e arritur, por edhe për të parashikuar sfidat e së ardhmes.

KAPITULLI I

1. Kuptimi , rëndësia dhe zhvillimi historik i adoptimit

1.1 Kuptimi i adoptimit

Adoptimi paraqet institucion juridik dhe shoqëror, me anë të të cilit midis adoptuesve dhe fëmijëve të adoptuar themelohet marrëdhënie prindërore. Të cilat varësisht nga lloji i adoptimit janë identike me marrëdhënien prindërore, adoptimi themelohet me akt juridik, domethënë në rrugë artificiale, e jo në rrugë natyrore si gjinia e gjakut ashtu që gjinia sipas adoptimit njihet si gjinia civile. Adoptimi është institut përmes të cilit fëmijëve pa prind dhe pa përkujdesje prindërore i jepet mundësia e strehimit dhe përkujdesjes nga një familje tjetër, e cila nuk është familje biologjike e atyre fëmijëve. Në këto raste këta fëmijë janë pa përkujdesje prindërore për shkak se prindërit e tyre nuk janë gjallë, apo janë të panjohur.

Mirëpo fëmijë pa përkujdesje prindërore konsiderohen edhe fëmijët prindërit e të cilëve janë të gjallë, mirëpo heqin dorë nga fëmijët e tyre si dhe nuk ushtrojnë të drejta prindërore e as nuk mbajnë përgjegjësi për fëmijët e tyre. Të gjitha këto raste apo situata duhet merren parasysh nga çdo shoqëri dhe shtetet duhet të ndërmarrin masa të ndryshme dhe të gjejnë forma më të përshtatshme për mbrojtjen dhe strehimin e këtyre fëmijëve të braktisur.

Me themelimin e adoptimit, zgjedhet familja e cila do ta marrë fëmijën dhe do ta adaptojë si të vetin me qëllim që të kujdeset për atë fëmijë, ti ushtrojë të drejtat prindërore mbi të si dhe detyrimet që i ka ndaj atij fëmije. Në këto raste krijohen raporte të ngjashme prindër – fëmijë, mirëpo mënyra e themelimit të këtyre raporteve apo marrëdhënieve është ligjore ngaqë themelohet me akte juridike dhe jo në mënyrë natyrore siç themelohet marrëdhënia familjare – prindërore midis prindërve dhe fëmijëve natyrorë.³ Gjatë adoptimit duhet patjetër të merret parasyshë interesi më i lartë i fëmijës, siç edhe theksohet në nenin 97 të Ligjit për familjen të

³ Abdulla Aliu , Haxhi Gashi , E drejta Familjare , Prishtinë 2007, fq.247-248

Republikës së Maqedonisë së Veriut “Adoptimi mund të krijohet vetëm nëse është në përputhje me interesin më të mirë të të miturit”.⁴

Gjithashtu domosdoshmëria që të respektohet interesi më i lartë i fëmijës është i theksuar edhe në Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve në nenin 21 sipas të cilit “Shtetet Palë, të cilët pranojnë dhe/ose lejojnë sistemin e adoptimit, garantojnë që konsiderata mbizotëruese të jetë interesi më i lartë i fëmijës dhe:

(a) Sigurojnë që adoptimi i fëmijës të autorizohet vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e zbatueshme dhe mbi bazën e të gjitha të dhënave përkatëse dhe të besueshme, që adoptimitë lejohet duke mbajtur parasysh gjendjen e fëmijës në raport me prindërit, të afërmit dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe, kur është e nevojshme, personat e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre të ndërgjegjshëm për adoptimin, mbi bazën e këshillimit të nevojshëm;

(b) Pranojnë se adoptimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar kujdesin për fëmijën, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje ushqyese ose adoptuese, ose të ketë një mënyrë tjetër të përshtatshme për kujdesjeje në vendin e tij të origjinës;

(c) Sigurojnë që, në rast adoptimi në një vend tjetër, fëmija të gëzojë mbrojtjen dhe normat e barazvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e adoptimit në vendin e tij;

(d) Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që, në rast adoptimi në një vend tjetër, vendosja e fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pavend për personat e implikuar në të;

(e) Mbështesin, sipas rastit, objektivat e këtij neni, duke përfunduar rregullime ose marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe dhe përpiqen në këtë kuadër të sigurojnë që vendosja e fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.⁵

⁴ Ligji për familjen ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 153/2014) neni 97

⁵ Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, neni 21

1.2 Rëndësia e adoptimit në shoqëri

Adoptimi si institut është shumë i rëndësishëm në çdo shoqëri për shumë arsye. Në përditshmëri hasim shumë raste të bashkëshortëve të cilët nuk kanë fëmijë dhe zgjidhja e vetme e duhur për ta është adoptimi , poashtu hasim edhe në ato lloj familjesh të cilat kanë fëmijë, mirëpo prapë bëhen adoptues të ndonjë fëmije dhe në të dyja këto raste padyshim se duhet të mbizotërojë interesi më i lartë i fëmijës.

Instituti i adoptimit është i njohur qysh në kohërat antike si në të drejtën Babilonase - tek kodi i Hamurabit , në të drejtën greke , në të drejtën romake etj. Qëllimi i adoptimit që nga koha e lashtë pa dyshim që ka ndryshuar në tërësi, pasi që në atë kohë qëllim i adoptimit nuk ishte mbrojtja e fëmijës dhe strehimi i tij, mirepo qëllimet ishin ekonomike apo për shkaqe trashëgimie, ndërkaq në ditët e sotme qëllim primar i institutit të adoptimit është mbrojtja e interesave të fëmijëve të mitur, përkujdesja prindërore ndaj këtyre fëmijëve, krijimi i marrëdhënieve shpirtërore me ta si dhe përkrahja e tyre në çdo hap të jetës njësoj sikur të ishte marrëdhënie biologjike prind – fëmijë.⁶

Instituti i adoptimit merr rëndësi për gjithë shoqërinë pasi është një institut i pa zëvendësueshëm përmes të cilit fëmijët e braktisur, apo fëmijët prindërit e të cilëve nuk janë gjallë vendosen në familje të tjera të cilat janë shpresa e vetme për ata fëmijë, për mirërritjen, edukimin dhe shkollimin e tyre. Në vendin tonë rastet më të shumta të braktisjes së fëmijëve janë prej momentit të lindjes pasi zakonisht bëhet fjalë për fëmijë jashtëmartesorë dhe mospranimi i atyre fëmijëve nga familjet e vajzave arrin deri tek braktisja e fëmijëve, Zakonisht në këto raste nënat janë të moshave të reja, dhe adoptimi është e vetmja mënyrë për zëvendësimin e dhimbjes së këtyre fëmijëve me dashuri .

⁶ Adoptimi i fëmijëve, trendet dhe politikat , (Child Adoption, Trends and Policies) New York, 2009, fq.6

1.3 Adoptimi në të drejtën romake

Sipas autorit Asllan Bilalli dhe Bedri Bahtiri në familjen romake ekzistonin marrëdhënie të atilla të cilat u bënë shkak për miratimin e rregullave të shumta juridike përmes të cilave në familje u instalua pushteti i *pater familias*, si për fëmijët që lindnin brenda në familje ashtu edhe ndaj personave tjerë të cilët me vullnetin e pater familias bënin pjesë në familje si anëtarë të familjes. Përmbledhja e të gjitha normave juridike me anën e të cilave sigurohej pushteti i *pater familias* ndaj të gjithë anëtarëve tjerë të familjes që ishin personat *alieni iuris* e përbënin të drejtën atërore romake. *Patria potestas* i përjetshëm i *pater familias* mbi pasurinë familjare si dhe mbi personat e definonte *patrias potestas* (pushtetin atëror). Pushtetit atëror i nënshtroheshin të gjithë personat, domethënë anëtarët e familjes pavarësisht faktit se a ishin në gjini gjaku me *pater familias* apo ishin në gjini kognate.⁷ Gjithashtu sipas autores Arta Mandro *Patria potestas* apo pushteti atëror ndaj personave *alieni iuris* krijohet në 3 mënyra edhe atë:

a) për fëmijët me anë të lindjes ;

b) për fëmijët e adoptuar me anë të adoptio dhe adrogatio (me vullnetin e pater familias)

c) për fëmijët natyrorë për shkak të legjitimitetit.⁸ Adoptimi në Romën e lashtë praktikohet dhe bëhet nga shtresat e larta; një numër i madh adoptimesh u kryen nga klasa senatoriale. Trashëgimia dhe trashëgimia familjare ishin shumë të rëndësishme; prandaj, romakëve u duheshin mënyra për të kaluar pasurinë dhe emrin e tyre kur nuk ishin në gjendje të krijonin një trashëgimtar mashkull. Adoptimi ishte një nga mënyrat e pakta për të garantuar trashëgiminë, kështu që u bë rregull adoptimi i meshkujve të rinj në shtëpitë e familjeve të rangut të lartë. Për shkak të ligjeve romake të trashëgimisë (Lex Falcidia), gratë kishin shumë pak të drejta ose aftësi për të trashëguar pasuri. Kjo i bëri ato më pak të vlefshme për adoptim. Megjithatë, gratë ishin ende të adoptuara dhe ishte më e zakonshme që ato të martoheshin në një familje me ndikim.⁹

⁷ Asllan Bilalli , Bedri Bahtiri , E drejta Romake , Prishtinë 2015, fq. 189,190

⁸ Arta Mandro , E drejta Romake , Tiranë 2007 , fq.202

⁹ https://penelope.uchicago.edu/Thayer/E/Roman/Texts/secondary/SMIGRA*/Adoptio.html

1.3.1 *Filii familias me anē tē adrogatio*

Filii familias bëheshin 3 lloj personash :

për shkak lindjes

me anë të adoptimit

me anë të legjitimitit

Filii familias me anë të adrogatio ishte adoptimi i një sui iuris . *Adrogatio* – në adrogatio merrnin pjesë tipi më antik i asambleve popullore i quajtur *comitia curiata* populli ishte i grupuar në tridhjetë kuri dhe me rastin e *adrogatio* një *pontifex* i drejtonte komisionet kuriate, i cili pasi i bënte hetimet e legjitimitetit dhe për thelbin e çështjes, dy persona të interesuar i pyeste rreth vullnetit për të adroguar dhe për t’u adroguar. Në ato raste ku personit që drejtonte komisionet kuriate *pontifex* i jepej një përgjigje pozitive ai më pas paraqiste një *rogatio* apo ndryshe propozim popullit, që më pas duhej të jepte pëlqimin e vet, dhe kur populli jepte pëlqimin adrogatio si akt juridik konsiderohej i plotë.¹⁰ Sipas autorit Ken Dhima *Comitia curiata* ishte e përbërë vetëm nga meshkuj , gratë ishin të përjashtuara dhe për këtë arsye ato nuk mund të adrogoheshin. Gratë nuk mund të ushtronin *patria potestas* mbi personin e adroguar kështu që kjo mundësi u jepej vetëm meshkujve, gratë nuk mund as edhe të adrogonin. Gjithashtu në *comitia curiata* apo asamblatë popullore ishin të përjashtuar edhe meshkujt të cilët nuk e kishin mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç të cilët quheshin impuberë. Ata nuk mund as të adrogonin e as të adrogoheshin . Më vonë personat nën moshën katërbëdhjetë vjeç mund të adrogoheshin mirëpo vetëm nëse ekzistonte një shkak i drejtë dhe i arsyeshëm. Shkak i arsyeshëm dhe i drejtë mund të ishte lidhja atërore që mund të ishte mes adrogesit dhe të adroguarit. Mirëpo pavarësisht këtyre rrethanave adrogimi, i personave impuberë bëhej me leje nga tutori i këtyre personave dhe bëheshin veprime hetuese sa i përket moralit dhe gjendjes pasurore të adrogesit.(Ken Dhima , E drejta Romake , Tiranë, 2007 , fq.448)¹¹

¹⁰Adoptimi i fëmijëve, trendët dhe politikat , (Child Adoption, Trends and Policies) New York, 2009 fq.7

¹¹ Ken Dhima , E drejta Romake , Tiranë, 2007 , fq.448

Sipas autores Arta Mandro që të kryhej adrogimi , ishte rregull që adroguesi të ishte më i vjetër në moshë se i adroguari të paktën 18 vite, të mos kishte fëmijë tjerë natyror dhe të adoptuar si dhe të mos ishte më i varfër se i adroguari. Adrogues nuk mund të ishin personat më të vjetër së gjashtëdhjetë vjeç. Adrogimi si institut në fillim është praktikuar nga *pater familias* të cilët nuk kanë pasur trashëgimtarë, dhe ky institut u shërbente për të krijuar artificialisht një trashëgimtarë.¹²

Gratë mund të adrogoheshin me *adrogatio per rescriptum principis*, dhe me Dioklecianin, mund të adrogonin në rastet kur fëmijët i kishin vdekur dhe kur bëheshin vejusha. Edhe kur adroguese ishte gruaja, i adroguari bëhej *filiu familias* i adroguesit, ndërpritej *sui iuris* si dhe *pater familias*-i deritanishëm dhe pushtet mbi të kishte *pater familias*-i tjetër. Pasuritë të cilat i kanë takuar të adroguarit si dhe të gjitha të drejtat subjektive edhe kreditë kalonin në pronësi të adroguesit dhe ai bëhej titullar i tyre. Kalimi i gjithë këtyre të drejtave nga i adroguari tek adroguesi bëhej *inter vivos* .

¹² Arta Mandro, E drejta Romake , Tiranë, 2007 , fq.204

1.3.2 *Filii familias me anē tē adoptio*

Gjithashtu sipas autorit Ken Dhima ndryshe nga *adrogatio*, *adoptio* bëhej me personat *alieni iuris filius familias* i cili përmes *adoptio* kalonte prej një familje në familjen tjetër si *filius familias*, prej familjes biologjike në familjen e adoptuesit, duke ndërprerë çdo lidhje me familjen biologjike, mbi *filius familias* ndërpritej *patria potestas* e prindit biologjik dhe mbi të fitohej pushteti atëror i adoptuesit. Mirëpo që të fitohej *patria potestas* nga adoptuesi mbi *filius familias* ishte jo e lehtë, pasi që *pater familias* i mëparshëm kishte të drejtë deri në tre herë ta manciponte të birin e tij dhe pas herës të tretë *patria potestas* kalonte automatikisht tek adoptuesi, pasi që ajo e drejtë ishte vetëm 3 herë pas adoptimit nga *pater familias* i parë apo *pater naturalis*. Ishte një procedurë komplekse mirëpo ishte a domosdoshme për fitimin e *patria potestas* nga ana e adoptuesit.

Për dallim nga *adrogatio* tek *adoptio* mund të adoptoheshin si meshkujt ashtu edhe femrat. Mirëpo e ngjashme si tek *adrogatio* ishte se edhe tek *adoptio* personat të cilët kishin të drejtë të jepnin në adoptim ishin vetëm meshkujt ata të cilit kishin *patria potestas*.

Ekzistonin dy lloje të adoptimit në të drejtën romake edhe atë:

Adoptio plena dhe *adoptio minus plena* .

Adoptio plena ndryshe adoptim i plotë ishte adoptim i cili bëhej nga ana e gjyshit nga babai ose nga nëna e të adoptuarit. Efektet e këtij instituti ishin se braktisej familja biologjike domethënë ndryshohej dhe shkëputeshin lidhjet me familjen biologjike dhe barazohej plotësisht me trashëgimtarët dhe me personat *filii* të adoptuesit.

Adoptio minus plena ishte adoptim jo i plotë dhe bëhej nga një person i huaj dhe nuk ka sjell as fitimin e *patria potestas* apo pushtetit atëror, e i adoptuari nuk shkëput lidhjet me familjen biologjike dhe as nuk humb të drejtën trashëgimore.¹³

¹³ Ken Dhima , E drejta Romake, Tiranë, 2007, fq. 449,450,451

1.3.3 Gjendja juridike e *fili familias*

Sipas autorit Ken Dhima *Filii familias* ishin meshkujt dhe femrat , që ishin bijë të *pater familias* apo ishin të adoptuar prej tij si fëmijë me anë të *adrogatio* apo *adoptio* poashtu edhe nipërit dhe mbesat që ishin nën *patria potestas* të *pater familiasit*. Pushteti atëror në çdo rast e sillte varësinë e *filius familias* ndaj pushtetit të *pater familias*. Ky pushtet ishte i pa kufizuar, absolut, dhe shprehej si *ius vitae ec necis* që kishte kuptimin jetë a vdekje. Mirëpo sa i përket *fili familias* e drejta, feja dhe morali nuk kan patur qëndrime mos përfillëse duke i marrë në konsideratë ata.

Në periudhën antike ekzistonin disa sanksione të cilat ushtroheshin për rastet e abuzimit të *ius vitae ac necis*. Nga gjykimi i dhënë prej një gjykate shtëpiake e ashtuquajtura *indictum domesticum* që ishte organ familjarë dhe jo shtetëror në bazë të zakoneve bënte kontrollimin e ushtrimit të pushtetit të *pater familiasit* si dhe bënte gjykimin e sjelljeve me faj te personave *alieni iuris* në periudhën klasike u vendos që filius nuk mundej të vritej pa u ndëgjuar arsyet nga *princepsi* të cilat i paraqiste *pater familias*.

Gjithashtu edhe *ius vitae ac necis* që kishte *pater familias* mbi anëtarët e lirë të familjes u zhduk në fundin e periudhës klasike. Formë tjetër e *patria potestas* ishte edhe braktisja e të posalindurve që e bënte *pater familiasi* në rastet kur të posalindurin nuk e njihte si fëmijën e vet. *Pater familiasi* e kishte të drejtën për ta shitur me anë të *mancipatio* fëmijën e tij . Pavarësisht *patria potestas*, meshkujt *fili familias* kur bëheshin madhorë e fitonin zotësinë e plotë në të drejtën publike: mund të votonin asamblëtë popullore, mund të bëheshin magistratë dhe senator si dhe funksionarë perandorak. *Filii* dhe *filiae familias* të cilët arrinin pjekurinë seksuale mundeshin te lidhnin martesë të ligjshme por ishte e nevojshme leja e *pater familias*.

Sa i përket aspektit pasurorë pozicioni i *fili familias* ka qenë i njejtë me atë të skllëvërve. *Filii familias* sikurse skllëvërit ishtin të privuar nga zotësia juridike : nuk kishin të drejta personale dhe nuk mundnin të merrnin përsipër detyrime juridike. Mirëpo pozicioni i *fili familias* në aspektet pasurore do të ndryshojë në mënyrë progresive në krahasim me atë të skllëvërve.

Personave *fili familias* në periudhën e republikës iu njihet zotësia për të ndërmarrë *obligationes civiles* si dhe detyrime të cilat sanksionoheshin me padi.¹⁴ Kjo zotësi u njihej meshkujve dhe jo femrave, ndërsa personat e tretë kreditor kundër *fili familias* mund të ngritnin padi për njohjen dhe vërtetimin e kredisë. Për ekzekutimin e vendimit të cilin nuk e ka përmbushur *fili familias* kreditorët shpresonin në ndërprerjen e patria potestas të mbi *filius* që të bëheshin ata vetë *pater familias* të tij.¹⁵

Filius familias kishte zotësi për të qenë palë në gjykim. *Filius familias* prej periudhës klasike mund të paditej me padi penale. Në rastet kur *fili familias-it* i mungonte *pater familias* atij i njihej zotësia procedurale për të qenë paditës. Gjithashtu *fili familias-it* i njihej edhe zotësia procedural për të vepruar në emër të vetë në rolin e paditësit .

Duke filluar nga periudha klasike *fili familias* mund të merrnin përsipër jo vetëm detyrime civile por atyre u lejohej të kishin edhe pasuri të tyre. Hapin e parë në këtë drejtim e bëri *Augusti* i cili u dha të drejtë *fili familiasve* ushtarë për të disponue me testament të ardhurat nga shërbimi ushtarak dhe pasuritë që i fitonin gjatë këtij shërbimi. Në periudhën postklasike, *fili familiasve* u kontribohet edhe pronësia *bona maternal* që ishte pasuri nga trashëgimi i nënës por më vonë u kontribohej edhe pasuria *bona materni generis* - pasuritë që trashëgoheshin nga njerëzit nga nëna mirëpo jo drejtëpërdrejt nga nëna dhe më vonë fitonin të drejtën e pronësisë për pasuritë e fituara me lidhjen e martesës. Të gjitha këto pasuri të cilat i fitonte *fili familias* administronte dhe i gëzonte *pater familias* mirëpo ai nuk mund ti tjetërsonte. Ky pushtet i *pater familiasit* njihej si uzurfrukt ligjor.¹⁶

¹⁴ Ken Dhima , E drejta Romake , Tiranë, 2007, fq. 453,454

¹⁵ Richard P. Saller, "'Familia, Domus' dhe koncepti romak i familjes," Phoenix 38, nr. 4 (Dimër, 1984): 343

¹⁶ Ken Dhima , E drejta Romake , Tiranë, 2007, fq. 455,456

1.3.4 Ndërprerja e statusit të *filius familias*

Gjendja e *filius familias* mund të ndryshonte për arsye të ndryshme. *Pater familias* mund ta shiste duke e bër atë objekt të mancipatio dhe ka rënë në *mancipium* të personit të tretë. Mbi fëmijën e mancipuar dhe të shitur *pater familias* kishte ende *patria potestas* deri në momentin kur Ligji i XII Tabelave sanksionohet se *pater familias* i cili manciponte disa herë *filius familias* të tij , pas mancipimit të tretë humbiste *patria potestas* mbi fëmijën e tij.

Ligji i XII Tabelave i referohet personave *filius familias* të cilët ishin meshkuj dhe pasardhësve të tij. Mirëpo pozita juridike e *filius familias* ndryshonte edhe për shkaqe tjera të ndryshme : me rastin e *adoptio filius familias* binte nën *patria potestas* të një tjetër *pater familias* , vajzat mund të binin nën *manusin* e burrit , dhe kur fëmijët mund të humbisnin cilësinë e *filius familias* si pasojë e humbjes së lirisë apo qytetarisë. *Patria potestas* shuhej me vdekjen e *pater familiasit* , dhe me vdekjen e *pater familiasit* ndryshonte edhe gjendja juridike e *filius familias* dmth me vdekjen e *pater familiasit* personat që ishin *filius familias* meshkuj dhe femra nuk vazhdonin më të ishin *filius familias* dhe bëheshin *sui iuris* ndërsa fëmijët meshkuj ata merrnin titullin *pater familias*. Poashtu *patria potestas* mund të shuhej edhe kur *pater familias* ishte gjallë me anë të *emancipatio*. *Emancipatio* ishte veprim përmes të cilit *filius-i* çlirohej nga pushteti atëror, akt përmes të cilit *filius* fitonte cilësinë *sui iuris* duke shkëputur të gjitha lidhjet me familjen biologjike.¹⁷

Në kohën e lasht veprimi i *emancipatio* i nënshtrohej sanksioneve, sepse personi që emancipohej ngelte pa kujdesje familjare dhe ngelte në duart e fatit të tij. *Patria potestas* shuhej edhe në rastet kur *pater familias* ishte i padenjë, p.sh konsiderohej se është i padenjë kur ia lejonte dikujt aktin seksual me vajzën e tij apo kur lidhte martesë për shkak të incestit.¹⁸

¹⁷ Frier et al., 199, për përkufizimet e jurisprudencës familjare (Ulpiane) dhe marrëdhëniet gjatë dhe para periudhës perandorake. Vështrim paraprak i kufizuar disponohet nëpërmjet Google Books

¹⁸ Ken Dhima , E drejta Romake , Tiranë, 2007, fq 458

1.4 Adoptimi në islam

Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) një herë tha se një person që kujdeset për një fëmijë jetim do të jetë pranë tij në Parajsë dhe bëri me shenjë për të treguar se kjo afërsi do t'i ngjante dy gishtave ngjitur në një dorë të vetme. Vetë jetim, Muhamedi i kushtoi vëmendje të veçantë kujdesit për fëmijët. Ai vetë adoptoi një ish-skllav dhe e rriti me të njëjtin kujdes siç do të rriste një djalë të lindur.

Ndërsa muslimanët i kushtojnë rëndësi të madhe kujdesit për fëmijët jetimë, ka rregulla dhe praktika që ndryshojnë shumë nga mënyra sesi konsiderohen jetimët në kulturat e tjera. Rregullat vijnë drejtpërdrejt nga Kur'ani, i cili jep rregulla specifike për marrëdhëniet juridike midis një fëmije dhe familjes së tij/saj adoptuese. Kur muslimanët adoptojnë një fëmijë, identiteti i familjes biologjike të fëmijës nuk fshihet kurrë dhe lidhjet e tyre me fëmijën nuk ndërpriten. Kurani në mënyrë specifike u kujton prindërve adoptues se ata nuk janë prindërit biologjikë të fëmijës.

Në ajetin e pestë të sures së tridhjetë e tretë, Kur'ani shprehimisht thotë se djemtë e adoptuar do të emërohen sipas babait të tyre të lindjes, jo sipas babait të tyre adoptues. Ky ajet është interpretuar si ndalim i dhënies së të drejtave dhe legjitimitetit të trashëgimisë personave të adoptuar. Ndalimi rezulton nga dy parime: së pari, se "një shkelës bashkëshortor mashkull nuk ka të drejta ndaj një fëmije të lindur nga një marrëdhënie e paligjshme" dhe së dyti, se "një i huaj .. nuk mundet, me një konventë shoqërore, të pranojë të drejtat dhe përgjegjësitë ligjore të babait ligjor të fëmijës".

Për këtë arsye, vendet që ndjekin ligjin islam nuk e njohin institutin e adoptimit. Megjithatë, disa vende me shumicë myslimane, si Indonezia, Tunizia dhe Turqia, lejojnë praktikën e adoptimit. Duke pasur parasysh rëndësinë që i kushtohet në Kuran lidhjeve gjaku dhe farefisnore, preferohet që fëmijët jetimë ose të braktisur të vendosen me të afërmit.¹⁹

¹⁹ <https://travel.state.gov/content/travel/en/Intercountry-Adoption/Adoption-Process/how-to-adopt/adoption-of-children-from-countries-sharia-law.html>

1.4.1 Instituti islamik i *Kafalas*

Shumë vende që ndjekin ligjin islam lejojnë *kafalah* (nga arabishtja kaft: të kujdesesh për të) për fëmijët që janë shpallur të braktisur nga një gjykatës. *Kafalah* nuk i jep të drejta trashëgimore personit të adoptuar dhe në çdo rast, vetëm çiftet myslimane që kanë qenë të martuar për më shumë se tre vjet lejohen të praktikojnë *kafalanë*. Fëmijët që përfitojnë nga *kafalaja* ruajnë emrin e babait të tyre të lindjes. Edhe pse atyre nuk u jepen automatikisht të drejtat e trashëgimisë nga personi që i posedon, ata mund të emërohen si legatarë dhe të trashëgojnë nëpërmjet një testamenti.

Shumë nga vendet që nuk e njohin institucionin e adoptimit kanë zhvilluar ligje që përshkruajnë strategji dhe procedura alternative për të plotësuar nevojat e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror. Në thelb, ai përshkruan më shumë një marrëdhënie prind birësues. Disa nga rregullat në Islam që rrethojnë këtë marrëdhënie: Një fëmijë i adoptuar ruan mbiemrin (mbiemrin) e tij ose të saj dhe nuk e ndryshon emrin e tij ose të saj që të përputhet me atë të familjes adoptuese. Një fëmijë i birësuar trashëgon nga prindërit e tij origjinalë biologjikë, jo automatikisht nga prindërit birësues.

Kur fëmija rritet, anëtarët e familjes birësuese nuk konsiderohen të afërm gjaku dhe për këtë arsye nuk janë muhrim për të. "Muhrim" i referohet një marrëdhënie juridike specifike që rregullon martesën dhe aspektet e tjera të jetës. Në thelb, anëtarët e familjes birësuese do të ishin të lejueshëm si partnerë të mundshëm martese dhe ekzistojnë rregulla modestie midis fëmijës së rritur dhe anëtarëve të familjes adoptuese të seksit të kundërt. Nëse fëmija pajiset me pasuri nga familja biologjike, prindërit adoptues urdhërohen të mos e përziejnë atë pasuri me të tyren. Ata shërbejnë thjesht si administrues të besuar për pronën që i jepet fëmijës nga familja e tij biologjike. Këto rregulla islame i theksojnë familjes adoptuese se ata nuk po zënë vendin e familjes biologjike, por po shërbejnë më tepër si kujdestarë dhe kujdestarë të fëmijës së dikujt tjetër. Roli i tyre është shumë qartë i përcaktuar, por megjithatë shumë i vlerësuar dhe i rëndësishëm. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se në Islam, rrjeti i familjes së zgjeruar është i gjerë dhe shumë i fortë. Është e rrallë që një fëmijë të mbetet plotësisht jetim pa një

anëtar të vetëm biologjik të familjes që të kujdeset për të. Islami vë një theks të madh në lidhjet farefisnore - një fëmijë i braktisur plotësisht është shumë i rrallë në kulturën islame.²⁰

Ligji islam e vë theksin në gjetjen e një të afërmi për t'u kujdesur për fëmijën dhe vetëm kur kjo rezulton e pamundur, e lejon dikë jashtë familjes - dhe veçanërisht jashtë komunitetit ose vendit të adoptojë dhe largojë fëmijën nga familja e tij ose e saj, rrënjët kulturore dhe fetare.²¹

²⁰ <https://www.learnreligions.com/adopting-a-child-in-islam-2003804>

²¹ <https://www.jurist.org/commentary/2012/11/faisal-kutty-adoption-kafalah/>

1.5 Zhvillimi historik i adoptimit në Maqedoninë e Veriut

Pas sjelljes së Ligjit mbi familjen në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 1992, janë bërë plotësime dhe ndryshime të tij në zbatimin e masave juridiko-familjare për mbrojtjen juridiko-familjare të fëmijëve. Mirëpo ende çështja e zbatimit të dispozitave ligjore sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore nuk është në nivel të duhur, si nga ana e institucioneve kompetente gjithashtu edhe nga ana e personave tjerë përgjegjës për përkujdesjen e fëmijëve.

Ky institut edhe pse rregullohet me ligj nuk praktikohet dhe ka shumë ngecje në zhvillimin e tij. Fëmija meriton më të mirën e mundshme dhe duhet marrë në konsideratë interesi më i lartë i tij. Braktisje të fëmijëve hasim çdo ditë dhe kudo mirëpo insituti i adoptimit për këta fëmijë pa prind dhe pa përkujdesje prindërore nuk përdoret dhe nuk i kushtohet shumë rëndësi si metodë apo formë e duhur për mbështetjen e këtyre fëmijëve. Në Republikën e Maqedonisë, çështja e fëmijëve të adoptuar është e rregulluar me Ligjin mbi familjen të vitit 1992 si dhe me disa ligje të veçanta. Ndërlidhur me këtë, duhet shtruar faktin se, Ish-Republika Socialiste e Maqedonisë ka pasur në fuqi ligj të veçantë i cili ka rregulluar institucionin e adoptimit, Ligji mbi adoptimin e fëmijëve i vitit 1973, kurse në vendet e Ish-Jugosllavisë gjithashtu ka patur ligj mbi adoptimin e fëmijëve i vitit 1947, respektivisht Ligji themelor mbi adoptimin ivitit 1965.

Gjithashtu edhe populli jonë nuk e ka të qartë rëndësinë e adoptimit, kushtet për themelimin e tij domethënë nuk e kanë të qartë ligjin sa i përket këtij instituti. Në popullin tonë ky institut zakonisht praktikohet përmes familjeve ku çiftet të cilët nuk kanë fëmijë atyre u sigurojnë fëmijë familjarët e tjerë. Ata prej momentit të lindjes ua japin fëmijën dhe ata prej lindjes gjithmonë kujdesen për atë fëmijë pa ndërprerje. Mirëpo në rrethinën tonë ka raste ku atij fëmije nuk i tregohet e verteta se fëmijë i kujt është apo cilët janë prindërit e tij të vërtetë. Ka raste ku pas moshës 18 vjet i tregohet se cilët janë prindërit e tij . Instituti i adoptimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullohet me: Ligjin për familjen (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.83/2004) , Ligjin mbi mbrojtjen sociale (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.21/2006), Ligjin mbi trashëgiminë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 47/1996), Ligjin për emrin personal (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 08/1995), Ligjin mbi evidencën amë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 08/1995), Ligjin mbi të drejtën

ndërkombëtare private (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 87/2007), Ligjin mbi shtetësinë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.45/2004). Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për adoptuesit e mundshëm, 1.X.2004,²² Rregulloren për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes elektronike të adoptuesve Nr. 10, datë: 25.01.2011 e ndryshuar me Rregulloren Nr.10-2831/3, datë 08.05.2012.²³

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë tre Institucione publike për strehimin e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore. Jetimorja për përkujdesjen e fëmijëve prej 0 deri në 3 vjeç në Manastir ka kapacitet prej 120 shtretërve, ku për momentin janë të vendosur 98 fëmijë. Në shtëpinë për fëmijë pa prindër '11 Tetori' në Shkup strehohen fëmijët në moshën mbi tre vjeçare deri në mbarimin e shkollës së mesme respektivisht më së voni 6 muaj pas mbarimit të shkollës së mesme, pra deri në mëvetësimin e tyre për punë. Në këtë jetimore janë vendosur afër 88 fëmijë.²⁴ Këto institucione i ngjajnë më shumë një strehimoreje ku fëmijët sigurojnë vetëm kushtet elementare për të mbijetuar (sigurojnë ushqimin dhe fjetjen dhe deri diku ofrohet edhe përkujdesi shëndetësor), mirëpo këto institucione fare pak ndikojnë në zhvillimin e tyre psikosocial dhe integrimin e tyre në shoqëri. Pavarësisht rëndësisë së këtij instituti, ligji për familjen i RMV-së përmban shumë pak nene me të cilat rregullon institutin e adoptimit, prandaj është shumë e nevojshme sjellja e një ligji të veçantë sa i përket adoptimit të fëmijëve pa prind dhe përkujdesje prindërore . Adoptimi themelohet para Komisionit të formuar nga Ministri për punë dhe politikë sociale në pajtueshmëri me dispozitat ligjore. Komisioni luan rol të rëndësishëm prej momentit të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga adoptuesit potencial e deri në sjelljen e vendimit përfundimtar për adoptim. Komisioni përbëhet prej një personeli me persona të kualifikuar me përvojë prej 15 viteve në fushën e adoptimit, edhe atë: juristë,

²² Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrimit për adoptuesit e mundshëm "Gazeta Zyrtare e RM " Nr.66.fq.77, http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/register_posvoiteli.pdf

²³ Rregulloren për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes elektronike të adoptuesve Nr. 10, datë: 25.01.2011 e ndryshuar me Rregulloren Nr.10-2831/3, datë 08.05.2012, https://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/pravilnik_poisvoitel.doc

²⁴ Arta Selmani Çështje të adoptimit në Maqedoni – RSHSL, Konferenca 2008

punëtorë social, psikologë dhe pedagogë. Vlen të theksohet që Komisioni për themelimin e adoptimit gjatë vitit 2007 ka kryer:

- 90 regjistrime të fëmijëve të mitur në regjistrin për të adoptuar të mundshëm,
- 60 adoptime të fëmijëve të mitur, prej të cilëve:
 - 51 raste të adoptimit të plotë të fëmijëve nga ana e adoptuesve shtetas të RM-së,
 - 7 raste të adoptimit të plotë të fëmijëve nga ana e adoptuesve shtetas të huaj,
 - 1 rast të adoptimit të plotë të fëmijëve nga ana e një çifti prej të cilëve njëri është shtetas i RM-s tjetri shtetas i huaj, mirëpo jetojnë në territorin e RM-së,
 - 1 adoptim jo të plotë të fëmijës së mitur

KAPITULLI II

2. Rregullimi juridik i adoptimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

2.1 Kuptimi dhe llojet e adoptimit

Adoptimi është institut juridik i të drejtës familjare përmes të cilit krijohen marrëdhënie familjare mirëpo në rrugë artificiale e cila dallon nga marrëdhënia natyrore prindër – fëmijë. Në nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut theksohet se Republika u siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa kujdes prindëror.²⁵Marrëdhëniet prindërore përmes adoptimit krijohen me anë të një akti juridik i cili miratohet nga organi kompetent.

Ky akt e përcakton rrugën artificiale për themelimin e këtij instituti. Pra kjo formë dallon nga mënyra biologjike e marrëdhënies prind-fëmijë, domethënë është imitim i mënyrës biologjike. Përmes këtij instiuti fëmijëve pa prind dhe pa përkujdesje prindërore u mundësohet plotësimi i mungesës së prindërve si dhe çifteve të cilët nuk kanë fëmijë u mundësohet plotësimi i ndjenjës së të qenurit prind. Adoptimi si institut juridiko familjar për qëllim primar ka mbrojtjen e fëmijëve pa prind dhe pa përkujdesje prindërore, si dhe qëllim tjetër ka që adoptuesit të ken fëmijë domethënë vihen në shprehje dy interesa të përbashkëta i fëmijës dhe i çifteve pa fëmijë.²⁶

Gjithashtu në nenin 4 paragrafi 3 të ligjit për shtetësinë të Republikës së Maqedonisë së Veriut theksohet se shtetësinë e Republikës së Maqedonisë nga origjina e fiton edhe i adoptuari në rast të adoptimit të plotë kur të dy ose njëri nga prindërit adoptues është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut.²⁷

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut Numër 08-4642/1

²⁶ Emine Zendeli, Arta Selmani, Dejan Mickoviq, Angel Ristov, E drejta Familjare, Tetovë 2020, fq.265,266

²⁷ Ligji mbi shtetësinë i Republikës së Maqedonisë së Veriut Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.45/04, 07.07.2004

Ekzistojnë disa lloje të adoptimit, si *Adoptimi i plotë (adoptio plena)* dhe *Adoptimi jo i plotë (adoptio minus plena)*. Poashtu janë edhe disa lloje tjera të adoptimit si psh. *nacional* dhe *ndërkombëtar* varësisht nga ajo se adoptimi a kryhet brenda shtetit dhe me shtetas të vendit apo jashtë shtetit nga shtetas të huaj. Në disa shtete marrëdhënie familjare themelojnë edhe çiftet me gjini të njejtë, ky adoptim njihet si adoptim nga ana e homoseksualëve.²⁸ Dispozitat e ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë së Veriut parashikojnë themelimin e dy llojeve të adoptimit. *Adoptimin e plotë* dhe *adoptimin jo të plotë*. Në bazë të ligjit për familje çfarë marrëdhëniesh do të krijohen me anë të adoptimit, a do të themelohet adoptim i plotë apo jo i plotë kjo varet nga dëshira e prindërve të të adoptuarit, adoptuesit, si dhe nga vetë fëmija që adoptohet nëse është mbi 12 vjeç.

Adoptimi i plotë - Marrëdhëniet të cilat themelohen me anë të adoptimit të plotë janë të pashkëputshme dhe të përhershme ku me themelimin e këtij lloji të adoptimit pushojnë të drejtat dhe obligimet mes të adoptuarit dhe familjes së tij të mëparshme ku përfshihet edhe e drejta në trashëgimi .

Adoptimi jo i plotë - Edhe tek ky lloj i adoptimit lindin të drejta dhe obligime sikur se ato që ekzistojnë midis prindërve dhe fëmijëve, mirëpo këtu i adoptuari ruan marrëdhëniet me familjen e tij të mëparshme apo biologjike. Domethënë me themelimin e adoptimit jo të plotë nuk vjen deri te humbja e drejtave dhe obligimeve të të adoptuarit ndaj prindërve të tij biologjik dhe të afërmve të gjinisë së gjakut.

Gjithashtu tek ky lloj i adoptimit i adoptuari ruan edhe të drejtat trashëgimore ndaj prindërve të tij biologjik dhe të afërmve të tij të gjinisë së gjakut, ku në nenin 115 parag.2 të ligjit për familje theksohet : “Të drejtat trashëgimore në mes adoptuesit dhe të adoptuarit dhe trashëgimtarëve të tijë gjat adoptimit jo të plotë janë reciproke”.²⁹

²⁸ Emine Zendeli , Arta Selmani , Dejan Mickoviq , Angel Ristov , E drejta Familjare , Tetovë 2020, fq. 267

²⁹ Neni 115 paragrafi 2 Ligji për familjen ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 153/2014)

2.2 Kushtet thelbësore për themelimin e adoptimit

Si kushte thelbësore apo esenciale janë ato kushte me mungesën e të cilave adoptimi nuk mund të themelohet, te kjo kategori e kushteve përfshihen :

- *Pjesëmarrja e personave të caktuar në procedurën e themelimit të adoptimit*
- *Dhënia e pëlqimit nga pjesëmarrësit në procedurën për themelimin e adoptimit*
- *Pjesëmarrja e organit kompetent në procedurën e adoptimit*

Ligji përcakton gjatë procedurës së adoptimit pjesëmarrjen e obligueshme për kategorinë e caktuar të personave, edhe atë : adoptuesi, bashkëshorti / ja i/e adoptuesit, prindërit e të adoptuarit apo njëri nga ata, kujdestari i tij, dhe në rastet kur i adoptuari është mbi 12 vjet është e obligueshme pjesëmarrja e tij. Gjithashtu ligji thekson se në disa raste të arsyeshme nuk nevojitet prania apo pjesëmarrja e bashkëshortit të adoptuesit kur ai nuk paraqitet si adoptues por pëlqimin e tij e ka dhënë pranë QPS në procesverbal ku janë shënuar adoptuesi dhe i adoptuari. Kusht esencial tjetër për themelimin e adoptimit të plotëfuqishëm është edhe dhënia e pëlqimit për adoptim. Ligji për familje përcakton se kush ka për obligim ligjor të jap pëlqimin për adoptim edhe atë: të dy prindërit e të adoptuarit , gjegjësisht kujdestari i tij, dhe i adoptuari në rastet kur ai është mbi 12 vjet, mirëpo në situata të caktuara nevojitet edhe pëlqimi i Komisionit për Adoptim kur fëmija adaptohet jashtë shtetit.

Adoptimi i plotëfuqishëm themelohet nga ana e organit i cili kompetencën e ka të percaktuar me ligj. Në disa shtete adoptimi kryhet në procedurë gjyqësore nga organet kompetente gjyqësore të cilat sjellin vendimin e plotëfuqishëm për adoptim, kurse në disa shtete adoptimi kryhet në procedurë administrative siç është edhe vet shteti ynë, organe administrative janë : QPS dhe disa organe të tjera për realizimin e kësaj procedure që janë Komisioni për Adoptim, organi i kujdestarisë, komitetet si organe për udhëheqjen e procedurës së adoptimit, agjensionet vendase dhe të huaja Organ i autorizuar për të zhvilluar procedurën e adoptimit sipas Ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Komisioni për adoptimin e fëmijëve në bashkëpunim me QPS në territorin ku adoptuesit e kanë vendbanimin³⁰

³⁰ Dejan Micković , Angel Ristov , Semejno Pravo (E drejta Familjare) ,Shkup 2015, fq.253

2.3 Kushtet për vlefshmërinë e adoptimit

Kushtet për plotfuqishmërinë e adoptimit janë ato kushte me mungesën e të cilave nuk mund të themelohet adoptimi i plotfuqishëm.

Këto janë kushtet që duhet të plotësojë fëmija që të mund të adoptohet , kushtet që duhet të plotësojë personi i cili dëshiron të adoptojë fëmijë, dhënia e pëlqimit nga prindërit e fëmijës për t'u adoptuar gjegjësisht kujdestari i tij, pëlqimi i vet fëmijës nëse është mbi moshën 12 vjet, dhe themelimi i adoptimit në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me dispozitë ligjore.

2.3.1 I adoptuari

I adoptuar konsiderohet fëmija në interes të cilit themelohet insituti i adoptimit. Që fëmija të mund të adoptohet apo të vendoset tek familja tjetër organet kompetente duhet të kenë parasysh interesin dhe sigurimin e fëmijës. Që të mund të adoptohet fëmija duhen plotësuar disa kushte edhe nga ana e tij.

Këto kushte janë:

- Fëmija duhet të jetë *subjekt i së drejtës* – domethënë që fëmija të mund të adoptohet ai duhet të jetë i lindur. Fëmija i zënë i cili quhet embrion dhe fëmija i palindur (nasciturus) nuk e kanë aftësinë pasive për adoptim.
- *Mosha e fëmijës* – Ligji për familje parasheh se vetëm personat e mitur mund të adoptohen .³¹

Ligji e përcakton moshën prej kur mund të vendoset fëmija në adoptim. Adoptimi themelohet pas 3 muajve nga lindja e fëmijës. Kjo periudhë konsiderohet si më e përshtatshme për adoptimin e fëmijës sepse mund të përshtatet më mirë në familjen e re dhe nuk e ndien mungesën e familjes biologjike.

Ligji e parashikon kufirin maksimal të moshës për adoptim që është tetëmbëdhjet vjet dhe kufirin minimal që është tre muaj. Mirëpo ka edhe disa kufizime sa i përket moshës së adoptimit psh. nëse fëmija adoptohet nga i afërm i cili nuk është në gjini gjaku në vijë të drejtë deri në pakufi

³¹ Neni 107 i Ligjit për familjen (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 153/2014)

dhe në vijë të tërthortë deri në shkallë të dytë dhe që nuk jeton në territorin e RMV-së , fëmija mund të adoptohet deri në moshën 12 vjeçare.

- *Pëlqimi i dhënë nga fëmija që adoptohet* – Dhënia e pëlqimit nga ana e fëmijës që adoptohet është kusht tjetër për themelimin e adoptimit. Pëlqimi nga ana e të adoptuarit kërkohet në rastet kur fëmija është mbi moshën 12 vjeçare. Konventa Evropiane për adoptimin e fëmijës parasheh dhënien e pëlqimit nga fëmija . Konventa shteteve nënshkruese u le hapësirë që në ligjet e tyre nacionale të përcaktojnë moshën e fëmijës për dhënien e pëlqimit për adoptimin e tij, mirëpo kjo moshë të mos jetë mbi moshën 14 vjeçare.
- *Gjinia e gjakut si pengesë për adoptim* – fëmija i mitur i cili me adoptuesin gjendet në gjini gjaku në vijë të drejtë deri në pakufi dhe në vijë të tërthortë deri në shkallë të dytë nuk mund të adoptohet .
- *Statusi familjar i të adoptuarit* – Adoptimi ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve pa prind dhe pa përkujdesje prindërore. Në këtë kategori hyjnë: 1) fëmija, prindërit e të cilit nuk janë gjallë, 2) fëmija, prindërit e të cilit janë të pa njohur ose me vendbanim të panjohur, 3) fëmija prindërve të të cilit u është hequr aftësia për të vepruar dhe e drejta prindërore.

2.3.2 *Adoptuesi*

Që një personi t'i lejohet që të bëhet prind adoptues është e obligueshme plotësimi i kriteriumit që ka të bëjë me moshën madhore dhe aftësinë e plotë të veprimit. Ai duhet gjithashtu që dhe të drejtat prindërore t'i ushtojë në mënyrë të suksesshme. Sipas Ligjit për familje adoptues mund të jetë vetëm shtetasi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mirëpo në raste të caktuara me plotësimin e kushteve të caktuara me ligj adoptues mundë të jetë edhe shtetasi i huaj. Për realizimin e adoptimit nga shtetasit e huaj nevojitet pëlqimi i dhënë nga ana e Komisionit për adoptim. Pëlqimi jepet vetëm kur fëmija nuk mund të adoptohet brenda territorit të RMV-së.³²

Mosha e adoptuesit- Adoptues mund të jetë personi madhor i cili nuk është më i vjetër se 45 vjet. Në raste të caktuara Ligji bën përjashtim ku lejohet që adoptuesi të jetë mbi 45 vjet mirëpo me kusht që kufiri mes moshës së adoptuarit dhe adoptuesit mos ta tejkalojë moshën 45 vjet.

Ligji për familje është strikt me normë imperative sa i përket rasteve ku personit nuk do t'i jepet fëmija për adoptim. Fëmija nuk do t'i jepet në adoptim personit i cili mendohet se nuk është në gjendje të tillë të adoptojë fëmijë dhe ta realizojë interesin e fëmijës, edhe atë nëse:

-personit i është hequr e drejta prindërore, i është shqiptuar për shkak të veprës penale dënim me burg efektiv në kohëzgjatje mbi 6 muaj ; personit të cilit i është hequr apo kufizuar aftësia e veprimit; personi për të cilin ekziston dyshimi se pozitën e adoptuesit e shfrytëzon në dëm të të adoptuarit ; ai i cili ka ngecje në zhvillim psikik apo sëmundje që sjell rrezik për shëndetin e të adoptuarit; i cili ka pengesa fizike apo të meta nga të cilat dyshohet se nuk mund të kujdeset për të adoptuarin ; i cili është i varur nga droga apo substancat tjera psikotropike apo alkooli; i cili ka sëmundje të rënda ngjitëse ; dhe kur Qendra për Punë Sociale ka mendime negative lidhur me mundësinë që personi i caktuar të jetë adoptues. Ligji për familje përcakton se si adoptues mund të paraqitet vetëm një person, përjashtin në situatat kur si adoptues paraqiten të dy bashkëshortët. Sipas të drejtës tonë kur njëri prej bashkëshortëve dëshiron të adoptoj fëmijë nevojitet edhe pëlqimi i bashkëshortit tjetër.³³

³² Ligji për familjen ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 153/2014) neni99

³³Emine Zendeli , Arta Selmani , Dejan Mickoviç , Angel Ristov , E drejta Familjare , Tetovë 2020, fq 271 , 272

Sa i përket mundësisë së personave për të adoptuar fëmijë (adoptuesve), në nenin 102 të Ligjit mbi familjen i RMV-së janë të theksuar personat të cilët nuk mund të bëhen adoptues:

- a) që i është marrë ose përkufizuar e drejta prindërore, si dhe personi që i është shqiptuar dënim për vepër të kryer penale me dënim efektiv me burg në kohëzgjatje mbi 6 muaj;
- b) që i është kufizuar ose i është marrë aftësia afariste,
- v) për të cilin ekziston dyshim i bazuar se pozitën e adoptuesit do ta shfrytëzojë në dëm të të adoptuarit,
- g) i cili është i sëmurë psikik ose person me pengesa në zhvillimin intelektual, si dhe personi i cili vuan nga sëmundje që mund ta vë në rrezik shëndetin dhe jetën e të adoptuarit dhe
- d) pengesa fizike e të cilit është e asaj shkalle që ka mundësi me arsye të dyshohet në mundësinë që të kujdeset për fëmijën;
- gj) nëse është më i moshuar se 45 vjet;
- e) i varur nga droga ose substanca tjera psikotropike ose alkooli;
- zh) që ka sëmundje të rëndë kronike ose është i sëmurë nga ndonjë sëmundje ngjitëse e pashërueshme, dhe
- z) nëse mendimi i ekipit profesional të qendrës për punë sociale është negativ lidhur me mundësinë që ata persona të jenë prindër.³⁴

Duke marrë parasysh nenin 102 të cituar më lartë të ligjit për familjen në gjykatën Kushtetuese të RMV-së është inicuar procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 102 të ligjit për familje si dhe kjo gjykatë ka sjellë vendim lidhur me këtë procedurë të inicuar edhe atë:

1. *Vendimi për nenin 102*: Vasilço Ilijev, avokat nga Koçani, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dorëzoi iniciativë për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit, pikën d), zh), dhe z).

³⁴ Neni 102 i Ligjit mbi familjen ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 153/2014)

Sipas pretendimeve të iniciativës, dispozitat kontestuese të nenit 102 paragrafi 1 pika d) pika zh) në rubrikën: “i cili ka sëmundje të rëndë kronike” dhe pika z) të Ligjit për Familjen ishin në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 alineja 1, 3, 8 dhe 11, neni 9, neni 40, neni 41, neni 51, neni 54 dhe neni 112 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ndonëse neni 9 i Kushtetutës garantonte barazinë e qytetarëve para Kushtetutës dhe ligjeve dhe respektimin e parimit të mosdiskriminimit, sipas kërkesit, është cenuar garancia kushtetuese e barazisë në liri dhe të drejta pavarësisht nga statusi shoqëror, sepse personat me paaftësi fizike dhe personat e sëmurë kronikë u ndaluan drejtpërdrejt të bëhen prindër birësues, gjë që i vendosi ata në një pozitë të pabarabartë në krahasim me qytetarët e tjerë që mund të vepronin si prindër birësues. Gjithashtu, kjo kategori personash me aftësi të kufizuara fizike që donin të ushtronin të drejtën e garantuar të prindërimit nëpërmjet birësimit, u vendosën në një pozicion të pabarabartë në raport me personat e tjerë me aftësi të kufizuara fizike që vendosën të ushtronin prindërimin si prindër biologjikë të fëmijëve të tyre.

Rrjedhimisht, birësimi nuk është një e drejtë e qytetarëve, rrjedhimisht, themeli i birësimit nuk është i garantuar, adoptimi është vetëm një mundësi, e cila varet para së gjithash nga vlerësimi i përgjithshëm i autoriteteve kompetente, nëse është më e përshtatshme dhe në interesin më të mirë. të fëmijës që do të birësohet, i cili i nënshtrohet analizës, vlerësimit dhe vëzhgimit të të gjitha rrethanave në çdo rast konkret. Prandaj, duke pasur parasysh se diskriminimi në kuptimin e trajtimit të pabarabartë i referohet situatave që përfshijnë të drejta për qytetarët, sipas Gjykatës, dispozitat ligjore të kontestuara nuk mund të nënkuptojnë shkelje të parimit kushtetues të barazisë dhe mosdiskriminimit, që nënkuptojnë trajtim të barabartë të qytetarët në ushtrimin e të drejtave të tyre, liritë dhe të drejtat, duke pasur parasysh se nuk ekziston e drejta e birësimit si e drejtë për qytetarët, as e drejta e prindërimit (ekzistojnë vetëm të drejta dhe detyra prindërore), për të cilat nuk mund të flitet. një e drejtë e shkelur e birësimit. Sipas pretendimeve të iniciativës, pikat e kontestuara d), zh) dhe z) të nenit 102 paragrafi 1 i Ligjit janë kontestuar edhe nga pikëpamja e parimit të sundimit të ligjit, të përcaktuar në nenin 8 paragrafi 1. paragrafi 3 i Kushtetutës dhe siguria juridike e qytetarëve si pjesë përbërëse e saj. Përkatësisht, rregullimi në pikën e kontestuar e) të nenit 102 paragrafi 1 i Ligjit, sipas të cilit prindi adoptues nuk mund të jetë personi, paaftësia fizike e të cilit është e një shkalle të tillë që me të drejtë të dyshojë në

mundësinë e kujdesit për fëmijën. , sipas kërkuessit, ishte i paqartë dhe i pasaktë sepse standardi i dyshimit të arsyeshëm ishte një formulim shumë i gjerë nën të cilin mund të nënshtroheshin situata të ndryshme faktike, gjë që vinte në pikëpyetje parimin e shtetit të së drejtës.

Birësimi nuk është e drejtë e qytetarit, prandaj baza e birësimit nuk është e garantuar. Birësimi është një mundësi që varet mbi të gjitha nga vlerësimi i përgjithshëm i autoriteteve kompetente, nëse është më e përshtatshme dhe në interesin më të mirë të fëmijës që shteti të besojë përkujdesjen ndaj fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore në bazë të birësimit. , i cili i nënshtrohet analizës, vlerësimit dhe vëzhgimit të të gjitha rrethanave në çdo rast specifik. Gjithashtu, dispozitat e kontestuara ligjore i referohen institutit të birësimit të rregulluar me Ligjin për Familjen, në mënyrë që të drejtat e fëmijës dhe interesi më i mirë i tij janë të një rëndësie thelbësore për institutin e birësimit, pra pretendimet e bëra për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat sipas kërkuessit janë dëmtuar, nuk mund të ndërlihen dhe kontestohen përmes zgjidhjeve ligjore të përfshira në Ligjin për Familjen, sepse realizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar është objekt i rregullimit me ligj tjetër. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerësoi se në rastin konkret nuk mund të ngrihet çështja e përputhshmërisë së dispozitave ligjore të kontestuara me dispozitat e Kushtetutës të cilës i referohet kërkuessi në nismë.

Për sa u paraqit, Gjykata vendosi se Procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 102 paragrafi 1 pika d) pika zh) në rubrikën: “që ka sëmundje të rëndë kronike” dhe pika z) të Ligjit për familjen (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonia” numër 80) NUK INICOHET /1992, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/2010, 156/2010, 39/2012, 44/2012, 42/2015, 381, 104/2015, 150/2015 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 53/2021). Këtë vendim Gjykata e mori në përbërje nga kryetarja e Gjykatës, Dobrila Katsarska dhe gjyqtarët: Naser Ajdari, dr. Osman Kadriu, dr. Darko Kostadinovski dhe Vangelina Markudova.³⁵

³⁵ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RMV-së 09.03.2022, nr.136/2021 <http://ustavensud.mk/?p=21927>

2. *Vendimi për nenin 100-a: gjithashtu nga Gjykata Kushtetuese ka sjellë vendim për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 100-a edhe atë:*

Procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 100 a paragrafi 5 alineja 3 dhe 6 dhe nenit 104 paragrafi 2 të Ligjit për familjen (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 80/1992, 6/1996, 38) nuk është i filluar /2004, 33/2006, 84/2008, 67/2010 dhe 156/2010). Stamen Filipov nga Shkupi, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, ka dorëzuar iniciativë për iniciimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të ligjit nga pika 1 e këtij vendimi. Sipas pretendimeve në iniciativë me dispozitat e nenit 100-a paragrafi 5 paragrafët 3 dhe 6 të Ligjit, neni 8 paragrafi 1 paragrafi 3, neni 9, neni 40, neni 42 dhe neni 51 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonia ishte shkelur, sepse me kriteret e parapara për kushte materiale dhe nivel arsimor, prindërve birësues të cilët kishin mundësi më të dobëta materiale dhe nivel më të ulët të arsimimit në krahasim me ata që plotësonin kushte më të mira, u privuan nga e drejta e të drejtës, prandaj edhe antikushtetuesja e dispozitave ligjore të kontestuara. Nisur nga sa më sipër, pretendimet në iniciativë se me rastin e përcaktimit të kriterëve në nenin 100-a paragrafi 5 i Ligjit për Familjen, për përzgjedhjen e prindit birësues, gjendja shëndetësore, gjendja psikosociale, kushtet e banimit, koha e pritjes, martesore. Statusi ishte i mjaftueshëm si kriter, shtetësia dhe nuk duhej të parashikoheshin kushtet materiale dhe niveli i arsimimit. Kjo sidomos për shkak se kriteret ligjore duhet të japin një pasqyrë të plotë të personalitetit të birësuesit të mundshëm dhe shkallës së kushteve optimale të tij për realizimin e kujdesit prindëror ndaj fëmijës, këto kriteret në tërësi i nënshtrohen vëzhgimit dhe vlerësimit të autoritetit kompetent. dhe nuk janë individualisht të mjaftueshme për të shprehur kualifikimin e adoptuesit të mundshëm, ndaj është e drejta e ligjvënësit të përcaktojë një sërë kriteresh që do të ndihmojnë autoritetin në ushtrimin e kompetencave të tij në fushën e birësimit, të cilat bëjnë pjesë në marrëdhëniet e së drejtës familjare. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerësoi se për nenin 100-a, paragrafi 5, paragrafi 3 dhe 6 i Ligjit kontestues, nuk mund të ngrihet në mënyrë të arsyeshme çështja e respektimit të Kushtetutës, nga pikëpamja e pretendimeve në iniciativë.³⁶

³⁶ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 100-a, 16.03.2011, nr.189/2010-0-<http://ustavensud.mk/?p=10475>

2.4 Kushtet e përbashkëta për të adoptuarin dhe adoptuesin

Kusht themelor ligjor për themelimin e adoptimit të plotëfuqishëm është dallimi mes moshës së të adoptuarit dhe adoptuesit. Ligji përcakton se dallimi i moshës mes adoptuesit dhe të adoptuarit duhet të jetë minimumi 18 vjet dhe jo më shumë se 45 vjet. Kushti i dallimit në moshë mes të adoptuarit dhe adoptuesit nuk merret parasysh në dy raste:

- (1) kur fëmijën e adopton bashkëshorti i prindit të tij dhe
- (2) në rastet kur adoptohet vëllai ose motra i fëmijës së adoptuar.

Konventa për Adoptimin e fëmijëve e vitit 1967 e ka përcaktuar kufirin minimal të moshës së personave të cilët adoptojnë fëmijë edhe atë: adoptues nuk mund të jetë personi i cili është më i ri se 21 vjet dhe më i vjetër se 35 vjet. Ndërsa Konventa e re për Adoptimin e fëmijëve e vitit 2008, parasheh moshën minimale të adoptuesit prej 18 vjet dhe mosha maksimale deri në 30 vjet.³⁷

2.5 Pëlqimi i prindërve të fëmijës që adoptohet dhe pëlqimi i të adoptuarit

Pëlqimi i prindërve të fëmijës që adoptohet

Që të themelohet adoptimi i plotëfuqishëm nevojitet pëlqimi i deklaruar i dhënë nga ana e prindërve të fëmijës i cili adoptohet. Pëlqimin duhet ta japin të dy prindërit, mirëpo nëse vetëm njëri e ushtron të drejtën prindërore kërkohet pëlqimi vetëm nga ai. Në rastet kur prindi i fëmijës është i mitur përpos pëlqimit të tij nevojitet edhe pëlqimi i përfaqësuesit të tij ligjor.

Prindi i cili e ushtron të drejtën prindërore mund ta jap pëlqimin e tij për adoptim para Qendrës për Punë Sociale kompetente sipas vendbanimit të prindërve edhe pa qenë paraprakisht i caktuar adoptuesi. Kjo formë njihet si pëlqim blanko për adoptim. Nëse fëmija prindërit nuk i ka gjallë pëlqimin për adoptimin e tij e japin të afërmit e gjinisë së gjakut apo kujdestari i tij. Ndërkaq pëlqimin për adoptim të fëmijës pas lindjes në hapsirat e Qendrës për Punë Sociale në formë të shkruar e japin prindërit e fëmijës qofshin në bashkësi martesore apo bashkësi jashtë martesore. Pëlqimin e shkruan dhe e nënshkruan prindi, ku ai deklaron se fëmijën e tij e jep në adoptim. Pëlqimin nga prindi e nënshkruan personi i autorizuar i Qendrës për Punë Sociale.

³⁷ Emine Zendeli , Arta Selmani , Dejan Mickoviq , Angel Ristov , E drejta Familjare , Tetovë 2020, fq.273

Në rastet kur prindi i fëmijës është analfabet, pëlqimin për adoptimin e fëmijës e jep me anë të deklaratës para ekipit profesional të QPS-së, e cila shënohet në procesverbal. Në këtë deklaratë në vend të nënshkrimit prindi vendos shenjën e gishtit tregues. Para dhënies së pëlqimit për adoptim. QPS ka për obligim ta njoftojë prindin me pasojat e dhënies së deklaratës tillë. Këtë deklaratë prindërit mund ta japin pasi fëmija të ketë mbushur 3 muaj nga lindja. Ligji shprehimisht përcakton se pëlqimin e dhënë për adoptim të fëmijës prindërit biologjik mund ta tërheqin deri në momentin e sjelljes së vendimit për vendosjen e fëmijës në familjen adoptuese. Me ligj janë të caktuara rastet kur adoptimi mund të themelohet pa pëlqimin e prindit. Kjo ndodh kur:

- *Prindit, i është hequr e drejta prindërore apo aftësia për të vepruar , apo prindit tmbi 9 muaj nuk i dihet vendbanimi;*
- *Prindi, nuk ka treguar interes për fëmijën e tij i cili është i vendosur në institucion apo familje tjetër ;*
- *Po ashtu, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga personi të cilin nëna e ka treguar si prind të fëmijës të lindur jashtë martese, i cili në afat prej 3 muajve pas lindjes së fëmijës nuk ka inicuar procedurë për njohjen e atësisë.³⁸*

Pëlqimi nga fëmija që adoptohet

Pëlqimin për adoptim mund ta jep edhe fëmija që ka arritur moshën 12 vjeçare pavarësisht pëlqimit të dhënë nga prindërit e fëmijës. Në këtë moshë mendohet se fëmija është i aftë të kuptojë rëndësinë që ka për të adoptimi si dhe ta shpreh vullnetin e vet. Mirëpo nuk ka nevojë për pëlqimin e fëmijës nëse fëmija deri në moshën 12 vjeçare ka jetuar me adoptuesit . Pëlqimi i dhënë nga fëmija parashihet edhe në Konventën Evropiane për Adoptimin e fëmijës të vitit 2008. Në nenin 4 dhe 5 të Konventës theksohet se është me rëndësi që fëmija të kuptojë pasojat lidhur me procedurën e adoptimit. Konventa u le hapësirë shteteve nënshkruese që në legjislacionet e tyre nacionale të caktojnë kufirin e moshës kur fëmija mund ta japë pëlqimin e tij për adoptim. Kjo moshë duhet të mos jetë mbi 14 vjeç.

³⁸ Emine Zendeli , Arta Selmani , Dejan Mickoviq , Angel Ristov , E drejta Familjare , Tetovë 2020, fq.274

2.6 E drejta që të dihet prejardhja e fëmijës

Fëmija i cili është mbi moshën 12 vjeçare ka të drejtë të jap pëlqimin e tij për adoptim ku edhe është në gjendje të kuptoj rëndësinë dhe pasojat që rrjedhin nga adoptimi. Mirëpo në rastet kur adoptohet fëmija i vogël ai ka të drejtën ta njoh të vërtetën e prejardhjes së tij si dhe t'i njoh prindërit e tij biologjik.³⁹

Në Konventën Evropiane për Adoptim theksohet se fëmija i adoptuar ka të drejtën të ketë qasje te të dhënat e regjistruara sa i përket prindërve të tij të vërtetë.⁴⁰ Prindërit biologjik mund të zgjedhin që të mos zbulohet identiteti i tyre , mirëpo organi kompetent duke marrë parasysh të drejtat e fëmijëve mund ta tejkalojë të drejtën e prindërve dhe t'ua zbulojë identitetin. Kjo dispozitë e garantuar në Konventë ndërkombëtare në legjislacionin tonë nuk qëndron. Adoptuesit nuk kanë për obligim që fëmijës t'ia komunikojnë të vërtetën rreth prejardhjes së tij dhe faktit që është i adoptuar.

Fëmija i adoptuar të vërtetën rreth adoptimit e kupton kur do që të jetë , mirëpo adoptuesit duhet të gjejnë kohën e duhur kur fëmija e pret më së miri dhe me qetësi faktin që është i adoptuar. Fëmijës të vërtetën rreth adoptimit duhet t'ia komunikojnë personalisht prindërit adoptues dhe kurrsesi të tjerët. Sepse është mirë që mos të arrijë familja në atë pikë që i adoptuari të dëshpërohet nga prindërit adoptues dhe të braktisë shtëpinë. Një familje qoftë tërësisht biologjike, qoftë e formuar përmes adoptimit asnjëherë nuk duhet të funksionojë me gënjeshtër dhe intriga. Kur fëmijës i komunikohet se është i adoptuar më shumë i shfaqet sinqeriteti dhe bindja se ata prindër edhe pse nuk e kanë fëmijë biologjik e duan të vërtetën dhe mes tyre krijohet një raport i sinqertë pa gënjeshtër dhe intriga.

³⁹ Neni 7 të Konventës mbi të drejtat e fëmijës, viti 1989

⁴⁰ Neni 22 paragrafi 3 i Konventës Evropiane për adoptimin e fëmijëve Strasbourg, 27.XI.2008

KAPITULLI III

3. Procedura dhe efektet e adoptimit

3.1 Komisioni për themelimin e adoptimit

Komisioni për adoptimin e fëmijëve luan një rol shumë të rëndësishëm gjat zhvillimit të procedurës së vendosjes së fëmijës në adoptim. Komisioni për adoptimin e fëmijëve bashkëpunon me Qendrën për Punë Sociale gjatë të dy fazave të zhvillimit të procedurës.

Inicimi i procedurës bëhet me anë të kërkesës të cilën e parashtrajnë palët e interesuara për themelimin e adoptimit domethënë adoptuesit potencialë. Kërkesa për adoptim i paraqitet Komisionit për Themelimin e Adoptimit pranë Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale.

Së bashku me kërkesën për adoptim duhen paraqitur edhe dokumentet e nevojshme. Kto dokumente janë të përcaktuara me Rregulloren për mënyrën e mbajtjes së evidencës për personat e adoptuar dhe dokumentet e nevojshme për adoptim.⁴¹ Këto dokumente janë:

- *Çertifikata e shtetësisë,*
- *çertifikata e lindjes, vërtetim nga Gjykata se nuk janë të dënuar,*
- *vërtetim nga Gjykata se nuk u është hequr e drejta prindërore, vërtetim nga Gjykata se nuk u është hequr aftësia e veprimit ,*
- *vërtetim mjekësor për gjendjen shëndetësore dhe aftësinë psikofizike,*
- *dëshmi për pronësi të banesës apo shtëpisë, vërtetim për nivelin e arsimimit,*
- *çertifikata e kurorëzimit nëse parashtruesit e kërkesës janë të martuar.*

Këto dokumente kanë vlefshmëri 1 vit nga dita e lëshimit të tyre. Komisioni për Adoptim kryen vërtetimin e gjithë dokumenteve të nevojshme dhe pas konstatimit se dokumentacioni është i kompletuar, kopjen e kërkesës së bashku me kopjen e lëndës konkrete në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës ia dorëzon Qendrës për Punë Sociale, kompetente në bazë të

⁴¹ Bazuar në nenin 104 paragrafi 2 të Ligjit për Familjen ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 80/92, 9/96, 38/04, 33/06, 84/08, 67/10 dhe 156/10) Ministri i Punës dhe Politikës Sociale miratoi rregullore për mbajtjen e evidencës së personave të adoptuar dhe për përcaktimin e dokumenteve të birësimit.

vendbanimit të parashtruesit të kërkesës. Komisioni kur konstaton se dokumentet e nevojshme janë të kompletuara bën regjistrimin e adoptuesit në regjistrin e adoptuesve potencial. Mirëpo nëse pas kryerjes së vlerësimit Komisioni konstaton se parashtruesi nuk i përmbush kushtet ligjore, Komisioni me vendim do ta refuzojë kërkesën për adoptim.⁴²

Komisioni për Adoptimin e fëmijëve përbëhet nga 15 anëtarë të emëruar nga Ministri për Punë dhe Politikë Sociale : juristë, pedagogë, psikologë dhe punëtor social (me së paku 5 vite përvojë në fushën e adoptimit). Mandati është 2 vjet, me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat.⁴³

Kryetari i Komisionit zgjedhet nga anëtarët e Komisionit në mënyrë elektronike në ditën e mbajtjes së çdo mbledhje. Komisioni për Adoptim ka disa role të rëndësishme prej të cilave disa i kemi theksuar edhe më lartë. Kështu Komisioni:

- *Shqyrton kërkesën e paraqitur nga adoptuesit potencial*
- *Vlerëson përmbushjen e kushteve materiale dhe formale dhe përshtatshmërinë e kërkesës*
- *Për çdo pengesë informon Qendrën për Punë Sociale kompetente sipas vendbanimit të adoptuesve potencial*
- *Sjell vendimin përfundimtar për adoptim.*⁴⁴

⁴² https://www.mtsp.gov.mk/te-drejta-sherbime-dhe-masa-nga-mbrojtja-sociale-ns_article-adoptimi-i-femijes.nsp

⁴³ Neni 97-a i Ligjit mbi familjen("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 153/2014)

⁴⁴ Emine Zendeli , Arta Selmani , Dejan Mickoviq , Angel Ristov , E drejta Familjare , Tetovë 2020, fq.275

3.2 Procedura e adoptimit

Procedura e adoptimit kalon nëpër dy faza, edhe atë : faza përgatitore (procedura paraprake) dhe faza e marrjes së vendimit të formës së prerë (procedura e themelimit të adoptimit),apo faza përfundimtare. Procedurën e adoptimit siç e theksuam edhe më herët e udhëheqin dy organe kompetente të lidhura njëra me tjetrën që janë Komisioni për Adoptim dhe Qendra për Punë Sociale. Në **fazën përgatitore** bën pjesë parashtrimi i kërkesës nga adoptuesit potencialë deri tek Komisioni për Adoptim bashkangjitur me gjitha dokumentet të cilat kërkohen si kusht kryesor për themelim të adoptimit. Me përmbushjen e gjitha kriteriumeve që kërkohen, Komisioni bën regjistrimin e parashtruesit të kërkesës në Regjistrin për adoptues potencialë.

Qendra për Punë Sociale në bazë të kompetencave të saj realizon veprime të caktuara gjatë procedurës së themelimit të adoptimit. Ligji parashikon afatet kohore brenda të cilave organet duhet t'i kryejnë veprimet e tyre procedurale dhe të japin mendimet e tyre në formë të shkruar lidhur me çështjet konkrete brenda procedurës paraprake. Qendra për Punë Sociale deri te e cila është dërguar kërkesa për adoptim bën vlerësimin e përshtatshmërisë së adoptuesve dhe motivin për adoptimin e fëmijëve. Veprimin e tillë e realizon nëpërmjet ndjekjes së adoptuesve së paku 4 muaj dhe në bazë të mendimit të ekspertëve harton propozim për regjistrim në regjistrin e adoptuesve potencialë.⁴⁵

Qendra për Punë Sociale poashtu këshillon adoptuesit që të ndjekin këshillmore apo trajtime përkatëse. Qëllimi i këshillave është që adoptuesit e ardhshëm të njihen me institutin e adoptimit, ushtrimin e të drejtave prindërore, zhvillimin e fëmijëve, përkujdesjen ndaj tyre, dhe rëndësinë e fëmijëve dhe familjes në tërësi. Pas përfundimit të trajtimit nga shërbimi për këshillim si dhe pas marrjes mendimit nga ekspertët, QPS në afat prej 10 ditëve Komisionit për Adoptim ia dorëzon dokumentet e nevojshme si dhe propozimin se personat konkret mund të regjistrohen si adoptues potencialë.

⁴⁵ Emine Zendeli , Arta Selmani , Dejan Mickoviq , Angel Ristov , E drejta Familjare , Tetovë 2020, fq.276

Komisioni në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të dokumenteve nga QPS sjellë vendim dhe bën regjistrimin në regjistrin për adoptues të mundshëm potencial nëse janë plotësuar kushtet ligjore.⁴⁶ Komisioni sjell vendim për shlyerje nga regjistri i adoptuesve potencial pas themelimit të adoptimit nëse konstaton se janë paraqit rrethana sipas të cilave parashtruesi i kërkesës nuk mund të jetë adoptues, nëse parashtruesi e tërheq kërkesën e bërë, në rast të lidhjes së martesës apo shkurorëzimit të martesës dhe në rast të vdekjes së adoptuesit.⁴⁷

Qendra për Punë Sociale i ndjek fëmijët e mitur pa prind dhe pa përkujdesje prindërore dhe jep propozim për regjistrim në regjistrin për të adoptuar të mundshëm potencial, të cilin propozim bashk me mendimin e ekspertëve dhe dokumentet ia dorëzon Komisionit.⁴⁸ Qendra për Punë Sociale raportin për shëndetin e fëmijës ia dorëzon Komisionit për vlerësim të gjendjes shëndetësore të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore. Pas pranimit të raportit për shëndetin e fëmijës, Komisioni bën regjistrimin në Regjistër për të adoptuar potencial. Komisioni sjell vendim për shlyerje nga regjistri i të adoptuarve potencial pas themelimit të adoptimit nëse prindi e tërheq pëlqimin e dhënë, nëse fëmija arrin moshën madhore, si dhe nëse vdes i adoptuari. Pas regjistrimit në regjistrin për adoptues potencial Komisioni në mbledhje, nga 3 adoptues potencial nga lista e përzgjedh adoptuesin që përshtatet më shumë. Kjo procedurë realizohet nga Komisioni në formë elektronike.⁴⁹

Pas përzgjedhjes së adoptuesit, Komisioni njofton Qendrën për Punë Sociale e cila ka rolin e kujdestarit për fëmijën, varësisht nga adoptuesi i zgjedhur kërkon që kujdestarinë e QPS ndaj fëmijës ta bartë tek QPS kompetente sipas vendbanimit të adoptuesit të zgjedhur dhe pushojnë gjitha të drejtat dhe detyrimet të Qendrës për Punë Sociale nën kujdestari të së cilës ka qenë fëmija.⁵⁰

⁴⁶ Neni 104-d i Ligjit mbi familjen ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 153/2014)

⁴⁷ <https://akademik.mk/servisni-informacii/postapka-za-posvojuvane-3/>

⁴⁸ Dejan Micković, Angel Ristov, Semejno Pravo (E drejta Familjare), Shkup 2015, fq 260

⁴⁹ Rregulloren për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes elektronike të adoptuesve Nr. 10, datë: 25.01.2011 e ndryshuar me Rregulloren Nr.10-2831/3, datë 08.05.2012, https://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/pravilnik_poisvoitel.doc

⁵⁰ D-r Kiril Čavdar, Komentar na zakonot za semejstvo (so sudska praktika, obrasci za praktična primena, predmeten registar i pridružni propisi), Shkup 1998, fq.219

3.3 Periudha provuese paraadoptuese

Për sjelljen e vendimit përfundimtar për adoptimin e fëmijës rol të rëndësishëm luan pjesa e adaptimit (përshtatmëria apo periudha e provës) të fëmijës i cili është në rrugë për t'u adoptuar tek familja e re. Përmes kësaj faze Komisioni vërteton përshtatshmërinë e zgjedhjes së adoptuesve. Përshkak të rëndësisë që ka krijimi i familjes dhe mardhëniet në të sidomos kur bëhet fjalë për adoptimin e plotë, është i obligueshëm realizimi i procedurës për ndjekjen e periudhës së përshtatjes para se të themelohet adoptimi. Komisioni pasi shqyrton nëse janë plotësuar kushtet e nevojshme për vendosjen e fëmijës në fazën e përshtatjes, sjell vendimin për sistemimin e fëmijës në familjen e adoptuesve si dhe ekzemplarët e dokumenteve të adoptuesve dhe të adoptuarit potencialë ia dorëzon QPS. Periudha e përshtatjes nuk mund të jetë më e gjatë se 3 muaj e as më e shkurtër se 2 muaj. Nëse adoptuesit janë shtetas të huaj është e obligueshme që gjysmën e periudhës adaptive ta kalojnë në territorin e shtetit tonë. Përpos nëse adoptohet fëmija i moshës 3 vjeçare atëherë periudha adaptive mund të zgjasë më shumë, por jo më shumë se 6 muaj.⁵¹

Komisioni ka për detyrë që të mbaj kontakte të vazhdueshme me adoptuesit për të bërë kontrollë se a është realizuar interesi i fëmijës dhe adoptuesit a ushtrojnë të drejtat prindërore në bazë të kërkesave të fëmijës. Kjo mbikqyrje realizohet me vizitën e familjes 1 herë në muaj në kohra të ndryshme të ditës. Periudha e përshtatjes dhe gjitha metodat që shfrytëzohen për mbikqyrje bëjnë pjesë tek masat juridike për mbrojtjen e interesit të fëmijës i cili adoptohet.

Kur përfundon periudha e përshtatjes së fëmijës në familjen e re, QPS në afat prej 5 ditëve e përgadit raportin lidhur me periudhën adaptive, dhe këtë raport ia dorëzon Komisionit për Adoptim.⁵² Pas pranimit të raportit dhe mendimit pozitiv të QPS-së lidhur me periudhën adaptive, Komisioni konstaton se adoptuesit janë të përshtatshëm si dhe adoptimi është në interes të fëmijës në afat prej 30 ditëve inicon procedurën dhe me plotësimin e gjitha kushteve ligjore e sjell vendimin për themelimin e adoptimit. Përndryshe nëse Komisioni vlerëson se raporti i sjellur nga QPS nuk është në interes të fëmijës, ka të drejtë që ta refuzojë themelimin e adoptimit.

⁵¹ Neni 104-i paragrafi 4 i Ligjit për Familjen,(Gazeta Zyrtare e RM, nr. 153/2014)

⁵² Neni 104-j paragrafi 1 i Ligjit për Familjen,(Gazeta Zyrtare e RM, nr. 153/2014)

3.4 Themelimi i adoptimit

Themelimi i adoptimit është një procedurë juridike e cila rregullohet me dispozita ligjore. Kjo procedurë është e ndërlidhur me plotësimin e kushteve materiale paraprake dhe kushteve formale. Kushtet duhen plotësuar nga personat të cilët kanë interes për themelimin e adoptimit por është i nevojshëm edhe plotësimi i kushteve formale nga ana e organeve kompetente për zhvillimin e kësaj procedure. Siç theksuam edhe më herët procedura për themelimin të adoptimit zhvillohet në dy faza: faza përgatitore dhe faza e marrjes së vendimit të formës së prerë ose faza përfundimtare. Kjo procedurë është e rregulluar me Ligjin për familje. Prania e adoptuesit është e nevojshme gjatë themelimit të adoptimit, po edhe bashkëshortit të tij, prindit, gjegjësisht kujdestarit të të adoptuarit. Edhe vetë i adoptuari duhet të jetë i pranishëm nëse është më i vjetër se 12 vjet, përpos të adoptuarit i cili ka jetuar me adoptuesin deri në momentin e themelimit të adoptimit para se të mbush 12 vjet. Në disa raste nuk është e nevojshme prania e bashkëshortit të adoptuesit kur ai pëlqimin e ka dhënë para Qendrës për Punë Sociale. Themelimi i adoptimit kryhet pa praninë e publikut.⁵³

Personi zyrtarë i Komisionit, në bazë të dokumenteve për identitetin personal të personave të pranishëm vërteton se a janë ato persona që janë të shënuar. Pastaj i njofton me detyrimet dhe të drejtat të cilat i kanë me themelimin e adoptimit dhe kërkon pëlqim nga personat të cilët në bazë të ligjit janë të obliguar ta japin. Vendimi për adoptim paraqet dokument në formë të shkruar. Ky dokument vërteton legjitimitetin e ndryshimit të statusit të fëmijës dhe ushtrimin e të drejtës prindërore nga adoptuesit përmes institutit të adoptimit ku edhe për këtë shkak është i nevojshëm vendimi i plotëfuqishëm. Gjatë gjithë zhvillimit të procedurës përpilohet procesverbal.⁵⁴ Në procesverbal evidentohen gjitha deklaratat e dhëna dhe veprimet procedurale të ndërmarra. Gjithashtu, si në vendim për adoptim ashtu edhe në procesverbal shënohen të dhënat për llojin e adoptimit i cili është themeluar, marrveshja për emrin përdonat të të adoptuarit, të dhëna për vendin e tij të lindjes.

⁵³ Ligji për familjen ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër153/2014) neni 105

⁵⁴ D-r Kiril Çavdar, Komentari në zakonot për sëmestvo (so sudska praktika, obrasci za praktična primena, predmeten registar i pridružni propisi), Shkup 1998, fq.223

Nëse adoptimi është jo i plotë shënohen edhe të drejtat e tij trashëgimore dhe marrëveshja për mbiemrin e fëmijës. Këtë procesverbal e nënshkruan personi zyrtar i QPS i cili përfaqëson fëmijën, prindërit e fëmijës (adoptimi jo i plotë), prindi i fëmijës, adoptuesit, kryetari dhe personi zyrtar i Komisionit.

3.5 Efektet juridike të adoptimit

Pas themelimit të adoptimit që është themeluar me anë të vendimit të formës së prerë, nga kjo marrëdhënie juridiko-familjare lindin detyrime dhe të drejta të ndërsjellta për palët, domethënë të drejtat dhe detyrime e adoptuesit ndaj të adoptuarit si dhe të drejtat dhe detyrimet e të adoptuarit ndaj adoptuesve. Vëllimi i këtyre të drejtave dhe detyrimeve varet nga ajo se a bëhet fjalë për adoptim të plotë apo adoptim jo të plotë. Si efekte juridike familjare që rrjedhin me themelimin e adoptimit janë : të drejtat prindërore, gjinia e adoptimit, adoptimi si pengesë martesore dhe mbiemri i të adoptuarit.

3.5.1 Mbiemri i të adoptuarit

Pasi themelohet adoptimi i plotë në librin amzë të të lindurve si prindër të fëmijës shënohen adoptuesit. Si vend i lindjes së fëmijës shënohet vendi të cilin me marrëveshje përcaktohet nga adoptuesit. Ndërsa me themelimin e adoptimit jo të plotë si mbiemër i të adoptuarit në Librin amzë të të lindurve regjistrohet mbiemri të cilin me marrëveshje e kanë përcaktuar adoptuesit gjithashtu theksohet se fëmija është i vendosur në adoptim jo të plotë.⁵⁵

Komisioni vendimin për adoptim ia dorëzon ofiqarit kompetent në afat prej 15 ditëve për ta regjistruar në Librin amzë të të lindurve. Pas regjistrimit të ri në Librin amzë të të lindurve ofiqari i gjendjes civile e njofton shërbimin e gjendjes civile për shlyerjen e regjistrimit të vjetër.

Përmes kësaj norme *ius cogens* zyrtarisht shlyhet identiteti dhe prejardhja e fëmijës, duke e regjistruar si fëmijë të adoptuesit. Në këtë mënyrë veprohet vetëm kur kemi të bëjmë me adoptim të plotë. Kur bëhet fjalë për adoptim jo te plotë në Librin amzë të të lindurve regjistrohet vetëm fakti i adoptimit.

⁵⁵ Ligji për emrin personal (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.08/95 e datës 15.02.1995)

3.5.2 E drejta për të trashëguar e të adoptuarit

Me themelimin e adoptimit të plotë i adoptuari dhe pasardhësit e tij e fitojnë të drejtën të jenë trashëgimtarë ligjor dhe testamental të adoptuesit. I gëzojnë të gjitha të drejtat trashëgimore sipas kushteve të parapara me dispozitat e Ligjit për trashëgimi. Domethënë i adoptuari dhe pasardhësit e tij kanë të drejta trashëgimie ndaj adoptuesit njësoj si të afërmit e gjinisë së gjakut. Mirëpo edhe adoptuesi dhe të afërmit e tij janë trashëgimtarë ligjor të të adoptuarit dhe të paslindurve të tij. Ndërsa vëllimi i të drejtave trashëgimore përmes adoptimit jo të plotë nuk është i njëjtë sikurse tek adoptimi i plotë. Tek adoptimi jo i plotë i adoptuari i ruan të drejtat trashëgimore ndaj prindërve të tij si dhe ndaj të afërmeve të gjinisë së gjakut.

I adoptuari dhe adoptuesi mund ta trashëgojnë njëri tjetrin në mënyrë reciproke mirëpo duke vendos kushtin "nëse adoptuesi në momentin e adoptimit nuk ka fëmijë të tij biologjik" Ky është një kufizim nga trashëgimia të të adoptuarit tek adoptimi jo i plotë. Këto të drejta trashëgimore rregullohen me Ligjin për trashëgimi në nenet 23-25. Nëse të drejtat trashëgimore të të adoptuarit nuk janë kufizuar ose përjashtuar, i adoptuari dhe pasardhësit e tij i kanë ndaj adoptuesit të drejtat e njëjta trashëgimore sikur se fëmijët e adoptuesit dhe pasardhësit e tyre, ndërsa adoptuesi ndaj të adoptuarit dhe pasardhësve të tij i gëzon të drejtat trashëgimore si të ishte prind i të adoptuarit.⁵⁶

3.6 Shuarja e adoptimit

Në të drejtën tonë me normë imperative ndalohet shkëputja e adoptimit të plotë. Mirëpo marrëdhënia prindërore e cila është themeluar me adoptim jo të plotë mund të shkëputet.⁵⁷

Pushimi i adoptimit jo të plotë mund të bëhet:

- me marrëveshje midis adoptuesit dhe të adoptuarit,
- me vendim të komisionit ex officio,
- me vendim të komisionit në baz të kërkesës së adoptuesit dhe të adoptuarit.

⁵⁶ Neni 23 i Ligjit për Trashëgimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁵⁷ Neni 116 dhe 117 i Ligjit për familjen (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 153/2014)

Kur i adoptuari është i mitur QPS ka për obligim të konstatojë nëse pushimi i adoptimit është në interes të të adoptuarit. Në rastet kur dukshëm marrëdhënia e adoptimit shkel interesat e fëmijës kërkesë për shkëputje të asaj marrëdhënie adoptive deri tek QPS mund të parashtrojë secili qytetar, organ apo person juridik.⁴⁵

3.7 Të dhëna statistikore mbi adoptimin e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sipas sondazhit “Zenskimagazin.mk” në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2021, 118 fëmijë në vend presin të adoptohen, ndërsa në regjistrin e adoptuesve të mundshëm janë regjistruar 280 adoptues potencial, prej të cilëve 192 janë shtetas të Maqedonisë, ndërsa 88 të tjerët janë shtetas të huaj. Procedura për adoptimin e fëmijëve mund të zgjasë nga disa muaj deri në disa vite. Derisa të mblidhet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm, të cilin adoptuesit e mundshëm duhet t'ia dorëzojnë Komisionit për Themelimin e Adoptimit pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, i cili përcaktohet në përputhje me të drejtën familjare.

Nga viti 2015, deri në gjysmën e parë të vitit 2021, grupa e fëmijëve të adoptuar nuk tregon ndonjë fluks konstant, interesi për adoptim ndryshon nga viti në vit, kështu që në vitin pandemik, 2020, është shënuar numri më i ulët i fëmijëve të adoptuar - 17, të gjitha të adoptuar nga shtetas të Maqedonisë. Sipas shëndetit mendor të 118 fëmijëve që aktualisht janë të regjistruar në regjistrin si të adoptuar të mundshëm, 18 kanë potencial të favorshëm zhvillimi, ndërsa nga 100 fëmijët e mbetur, 38 janë me aftësi të kufizuara të rënda psiqike, 38 fëmijë kanë devijime të moderuara në zhvillimin psiqik dhe 31 fëmijë me devijim të lehtë –sipas të dhënave nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Në gjashtë vitet e gjysmë të fundit janë adoptuar gjithsej 218 fëmijë, më së shumti në vitin 2017, gjithsej 50 fëmijë dhe më së paku në vitin e pandemisë 2020, kur u adoptuan vetëm 17 fëmijë. Ndërsa në gjysmën e parë të vitit 2021 janë adoptuar 10 fëmijë.

Mënyra e përzgjedhjes së adoptuesit bëhet në mënyrë elektronike në përputhje me Rregulloren, e cila përcakton kriteret dhe pikët, numri maksimal i të cilave mund të jetë 100.⁵⁸

⁵⁸ <https://zenskimagazin.mk/vo-makedonija-118-deca-chekaat-da-bidat-posvoeni-iako-interesot-za-posvojuvanje-e-dvojno-pogolem>

- *gjendja shëndetësore-3 pikë;*
- *statusi psikosocial-35 pikë;*
- *kushtet materiale-18 pikë;*
- *kushtet e banimit - 18 pikë;*
- *koha e pritjes-10 pikë;*
- *niveli i arsimimit-3 pikë;*
- *gjendja martesore-13 pikë dhe*
- shtetësia - për këtë kriter nuk jepen pikë, por prioritet kanë qytetarët e Republikës së Maqedonisë gjatë zgjedhjes elektronike të prindit adoptues.⁵⁹


⁵⁹ https://www.mtsp.gov.mk/te-drejta-sherbime-dhe-masa-nga-mbrojtja-sociale-ns_article-adoptimi-i-femijes.nsp

118 fëmijë presin të adoptohen


280 adoptues të mundshëm

218 fëmijë janë adoptuar gjatë gjashtë viteve e gjysmë të fundit

Numri i prindërve që duan të adoptojnë është më shumë se dyfishi i numrit të fëmijëve që presin të adoptohen.



Fëmijë të adoptuar në gjashtë vitet e fundit dhe në gjysmën e parë të vitit 2021



Të dhënat: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

KAPITULLI IV

4.Aspektet krahasuese të adoptimit mes disa shteteve të rajonit

4.1 Birësimi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë

Instituti i birësimit çdoherë ka qenë pjesë e të drejtës pozitive shqiptare. Qëllim primar i birësimit është sigurimi i fëmijës pa mjedis familjarë dhe vendosja e tij në një familje birësuese. Ky mjedis familjar në të cilin vendoset fëmija nuk është familja biologjike e tij. Në këtë mënyrë fëmija edukohet dhe rritet nga birësuesit sikur të jetë fëmijë biologjik i tyre.⁶⁰ Në nenin 240 të Kodit Familjes së Shqipërisë potencohet se birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore.⁶¹

Rëndësi të madhe duhet t'i jepet mbrojtjes së fëmijës nga përfitimet e pa drejta dhe çdo lloj veprimtarie që për synim ka shitjen, rrëmbimin dhe trafikimin e tyre. Në procesin e birësimit përfshihen dy lloje të autoriteteve që janë administrative dhe gjyqësore. Këto autoritete verifikojnë në mënyrë të përpiktë interesin e fëmijës si dhe a janë plotësuar të gjitha kushtet e domosdoshme për birësim. Është e drejtë e autoriteteve ta lejojnë apo ta refuzojnë birësimin varësisht nga kushtet e vendosura nga ligji. Marrëdhënia juridike e birësimit krijohet në këto raste:

- *Birësimi i të miturve shqiptarë, me vendbanim në Shqipëri, nga shtetas shqiptarë, brenda ose jashtë Shqipërisë;*
- *Birësimi i të miturve shqiptarë, me vendbanim në Shqipëri, nga shtetas të huaj, brenda ose jashtë Shqipërisë;⁶²*
- *Birësimi i të miturve të huaj, me vendbanim në Shqipëri, nga shtetas shqiptarë ose të huaj, brenda ose jashtë Shqipërisë;*

⁶⁰ Arta Mandro , E drejta familjare, familja, fëmijët, martesë, bashkëshortët, Tiranë , 2009 , fq.462

⁶¹ Ligji nr.9062, datë 08.05.2003, "Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimet i Republikës së Shqipërisë"

⁶² <http://www.njohligjin.al/familja/biresimi/>

- *Birësimi i të miturve shqiptarë ose të huaj, me vendbanim jashtë Shqipërisë, nga shtetas shqiptarë ose të huaj me vendbanim në Shqipëri.*

4.1.1 Kuptimi dhe kushtet për birësim

Birësimi është një institucion juridik i posaçëm që synon gjetjen e një familjeje birësuese zëvendësuese me atë biologjike për fëmijën që konsiderohet i braktisur e cila i ofron dhe garanton në vijim të drejta të plota. Kërkesa për të kryer birësim të një fëmije bëhet jo vetëm nga persona të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të kenë fëmijë biologjikë, por edhe nga persona që kanë fëmijë, por duan të marrin nën përgjegjësi e të rrisin fëmijë të cilët nuk kanë mundësi të rriten nga prindërit e tyre, apo janë fëmijë të braktisur. Birësimi bëhet gjithmonë në interes të fëmijës. Ky interes duhet të ekzistojë që nga momenti i birësimit e në vazhdim, edhe pas këtij momenti.

Kushtet që duhet të plotësohen për birësimin e një fëmijë janë:

1. Pëlqimi i dhënë nga këto persona :

- *personi që do të birësojë (birësuesi)*
- *bashkëshorti i birësuesit*
- *prindërit biologjik të të miturit (kur është e mundur)*
- *i mituri që birësohet nëse është mbi 12 vjeç*

Në ato raste kur fëmija është i braktisur dhe për këtë arsye nuk ka mundësi që prindi të japë pëlqimin, ligji situatën e rregullon nëpërmjet deklarimit të braktisjes së fëmijës së mitur. Gjykata mund ta deklarojë të braktisur të miturin e strehuar në institucion të përkujdesjes, ose pranë një personi që e ka marrë për përkujdesje. Vendimi i deklarimit të braktisjes së fëmijës do të jepet në kohën kur prindërit e të miturit nuk janë interesuar për fëmijën gjatë një viti para paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes. Kur i mituri ka jetuar në institucion për përkujdesje ndaj fëmijëve që nga lindja e tij, deklarimi i braktisjes së fëmijës mund të bëhet kur kanë kaluar 3 muaj nga data e lindjes së tij. Pasi të bëhet deklarimi se fëmija është braktisur, ai mund të birësohet.

Kërkesa për deklarimin e braktisjes bëhet nga drejtuesi i institucionit ku gjendet fëmija ose nga personi që e ka marrë për përkujdesje.⁶³

2.*Birësuesi* - mund të jetë çdo person të cilit nuk i është hequr apo kufizuar e drejta prindërore, nuk ka të meta mendore ose nuk vuan nga ndonjë sëmundje psiqike apo lloj tjetër që rrezikon jetën dhe shëndetin e të birësuarit. Ky person garanton se do ta kryejë në rregull detyrën e birësuesit në lidhje me mirërritjen, edukimin, dhe arsimimin e atij që do të birësohet .

3.*Diferenca e moshës* - dallimi apo diferenca e moshës ndërmjet të birësuarit dhe birësuesit duhet të jetë të paktën 18 vjet. Nëse birësohet fëmija i bashkëshortit, diferenca e moshës duhet të jetë jo më pak se 15 vjet.

4.*I birësuarit duhet të jetë i mitur nën 18 vjeç.*⁶⁴

⁶³ Ligji Nr. 9062, datë 08.05.2003, “Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimet i Republikës së Shqipërisë”

⁶⁴ Ligji Nr. 9695, datë 19.03.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”

4.1.2 Procedura administrative dhe gjyqësore e birësimit

Procedura administrative

Kjo procedurë fillon me kërkesën që personat e interesuar i bëjnë Komitetit Shqiptar të Birësimit, në të cilën paraqiten motivet për birësim të cilat shoqërohen me një sërë dokumentesh të domosdoshme për pranimin e aplikimit . Disa kategori subjektsh sjelljen e dokumenteve dhe kërkesën e bëjnë drejtpërdrejtë tek Komiteti dhe ka të tjerë që e bejnë me ndërmjetsimin e agjensive. ⁶⁵

Shtetasit shqiptarë me vendbanim në Shqipëri, të cilët dëshirojnë të birësojnë fëmijë shqiptarë, i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit. Drejtpërdrejt Komitetit mund t'i drejtohen edhe shtetasit shqiptarë rezident jashtë Republikës së Shqipërisë me kusht që vendimi gjyqësor shqiptar i birësimit të sjellë pasoja juridike në vendin e rezidencës. Rezident prej dy vitesh në Republikën e Shqipërisë apo shtetasit e huaj mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit, vetëm nëse legjislacioni i tyre nacional e lejon birësimin. Të huajt mund t'i drejtohen Komitetit vetëm nëpërmjet autoriteteve qendrore kompetente ose agjensive ndërmjetësuese të vendit të tyre, të njohura si të tilla nga Komiteti.

Kërkesa e birësimit shoqërohet me një numër të madh të dokumenteve që lidhen me identitetin e birësuesit ose bashkëshortëve birësues si në aspekt ekonomik, social, shëndetësor, moral, penal, familjar-martesor etj. Këto dokumente janë të përcaktuara nga neni 18 i ligjit për procedurat birësuese dhe Komitetin Shqiptar të birësimit 965/19.3.2007.⁶⁶

Aplikanti birësues paraqet në Komitet dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Kërkesën me motivimin e birësimit.*
- 2. Të dhënat personale për marrëdhëniet ndërpersonale të anëtarëve të familjes, informacione për pjesëtarët e familjes dhe qëndrimin e tyre ndaj birësimit.*
- 3. Të dhënat për gjendjen civile, si kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e martesës, certifikatën e zgjidhjes së martesës ose të vdekjes së bashkëshortit.*

⁶⁵ Arta Mandro, E drejta familjare, Tiranë 2009, fq.473

⁶⁶ Neni 18 i ligjit për procedurat birësuese dhe Komitetin Shqiptar të birësimit 965/19.3.2007

4. *Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.*
5. *Deklaratën për fëmijërinë, mënyrën e rritjes, edukimin dhe profesionin.*
6. *Raportin mjekësor dhe historinë mjekësore të familjes.*
7. *Vërtetime të punësimit, të të ardhurave dhe të pasurisë së paluajtshme.*
8. *Vërtetimin e pronësisë së banesës dhe të dhëna për kushtet e banimit.*
9. *Deklaratën me të dhënat për gjendjen ekonomike dhe sociale.*
10. *Vërtetimin, nga organet e njësisë së qeverisjes vendore të vendbanimit, për sjelljen dhe figurën morale.*
11. *Deklaratën e gatishmërisë së familjarëve dhe të miqve në mbështetje të aplikantit birësues.*

Pas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit për birësim pranë Komitetit, bëhet shqyrtimi i të drejtës së aplikantit në bazë të kushteve ligjore dhe dokumenteve të paraqitura . Nëse deri më këtë pikë konstatohet se kushtet janë plotësuar në bazë të ligjit, atëherë sekretariati ekzekutiv i Komitetit bën një studim lidhur me aftësitë birësuese të aplikantit nga këndvështrimi psiko social. Ky studim i aftësive birësuese i paraqitet për shqyrtim Këshillit drejtues të Komitetit i cili vendos nëse aplikanti është i përshtatshëm ose jo për të birësuar.

Nëse me vendim jepet përshtatshmëria për birësimin, atëherë ngarkohet sekretariati për vazhdimin e procedurës së birësimit. Mund të birësohen vetëm fëmijët që janë në të regjistruar në listat e Komitetit, domethënë fëmijët që janë deklaruar të braktisur, fëmijët për birësimin e të cilëve pëlqim kanë dhënë prindërit biologjik, fëmijët që ndodhen në përkujdesje për shkak se janë jetim, fëmijët me prindër të pa njohur, fëmijët prindërve të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar. Fëmijët mund të hiqen nga listat për arsye të ndryshme dhe nuk mund të birësohen. Si arsye të heqjes së fëmijëve nga listat për birësim janë:

- kur prindërit biologjik kanë tërhequr pëlqimin e dhënë për birësimin e fëmijës së tyre,
- kur me vendim të Gjykatës është vendosur që fëmija të qëndrojë me prindërit biologjik,
- kur fëmija është bërë madhor,
- kur fëmija vdes dhe
- kur fëmija mbi 12 vjeç kundërshton birësimin.

Pas vendimit të përshtatshmërisë së aplikimit, procedura administrative vazhdon me përgatitjen e dokumentacionit për fëmijën që birësohet dhe propozimin që fëmija të birësohet nga një familje shqiptare. Në rastet kur kjo nuk është e mundur dhe emri i fëmijës ka qenë në listat e Komitetit prej 6 muajve, aplikant birësues i mundshëm mund të jetë edhe nje familje e huaj. Dokumentacioni i fëmijëve që janë në listat e Komitetit si dhe që mund të birësohen përgatiten nga institucionet e përkujdesjes sociale ose të shërbimit social dhe i vihet në dispozicion Komitetit i cili verifikon dhe vlerëson dokumentacionin për çdo fëmijë që do të birësohet, dhe bën vlerësimin për gjetjen e familjeve të përshtatshme. Në nenin 22 të ligjit 965/19.3.2007 për procedurat birësuese dhe Komitetin Shqiptar të birësimit përcaktohet dokumentacioni i fëmijës që do të birësohet.

1. Sekretariati ekzekutiv verifikon dhe vlerëson dokumentacionin për çdo fëmijë që do të birësohet, të përgatitur nga institucionet e përkujdesjes sociale ose të shërbimit social pranë njësive të qeverisjes vendore. Vlerësimi i këtij dokumentacioni shërben për gjetjen e familjeve të përshtatshme, për të përballuar nevojat e fëmijës.

2. Dokumentacioni i fëmijës që do të birësohet përmban:

- a) certifikatën e lindjes;*
- b) raportin për gjendjen psikologjike, fizike dhe sociale të tij;*
- c) raportin për gjendjen shëndetësore ekzistuese dhe historikun mjekësor;*
- d) mendimin e fëmijës, nëse ai ka mbushur 10 vjeç, duke pasur parasysh aftësinë e tij për të arsyetuar. Kur fëmija ka mbushur moshën 12 vjeç paraqitet pëlqimi i vet;*
- e) kopje të letërnjoftimit të prindërve të tij biologjikë, nëse ata njihen;*
- f) raportin me të dhëna mbi historikun mjekësor të prindërve, nëse ato dihen, informacion për shtatzaninë dhe lindjen;*
- g) deklaratën me shkrim të prindit biologjik për pëlqimin ose vendimin gjyqësor, që ka dhënë pëlqimin për birësimin e fëmijës, ose vendimin gjyqësor që e ka deklaruar fëmijën të braktisur;⁶⁷*

⁶⁷ Neni 22 i ligjit për procedurat birësuese dhe Komitetin Shqiptar të birësimit 965/19.3.2007

- h) historikun e kalimit në kujdestari të fëmijës, nëse ka dhe të dhëna për kushtet në të cilat ka jetuar;*
- i) hollësi rreth jetës dhe zakoneve të tij.*

3. Data e lëshimit të raportit, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, duhet të jetë jo më parë se dy javë nga data e dorëzimit në Komitet e dokumentacionit për birësim. ⁶⁸

Në vazhdim aplikuesi i drejtohet përsëri me kërkesë Komitetit për caktimin e periudhës së provës. Prova ndihmon në verifikimin e përshtatshmërisë së birësuesit i cili aplikon me fëmijën. Periudha e provës përcaktohet nga Këshilli drejtues i Komitetit e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 3 muaj. Përgjatë kësaj periudhe krijohen marrëdhënie midis birësuesit dhe të birësuarit si dhe bëhet verifikimi i përshtatshmërisë konkrete.

Pavarësisht faktit që fëmija është i vendosur në provë me familjen birësuese , prindërit biologjik mund ta tërheqin pëlqimin e dhënë dhe të kërkojnë kthimin e fëmijës. Në qoftë se aplikanti birësues që i është dhënë fëmija në periudhën e provës refuzon ta kthejë fëmijën, prindërit mund t'i drejtohen përsëri Gjykatës. Gjykata mund të vendos për kthimin e fëmijës nëse është në interesin më të lartë të fëmijës. Procedura administrative përfundon kur konstatohet përshtatmëria e fëmijës me aplikuesin konkret, kur jepet pëlqimi me shkrim të Komitetit për birësim dhe përgaditet dosja për Gjykatë.⁶⁹

⁶⁸ Ligji Nr. 9695, datë 19.03.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”

⁶⁹ Arta Mandro, E drejta familjare, Tiranë 2009, fq.477

Procedura gjyqësore

Kur përfundon faza administrative Komiteti është i obliguar që ti dërgojë Gjykatës dosjen në të cilën ndodhen përshkrimi i gjithë fazës administrative i pasqyruar me këto dokumente: dokumentet e përgatitura për fëmijën që birësohet, dokumentet e përgatitura për aplikantin birësues, vendimin për përshtatshmërinë e aplikantëve, pëlqimin e Këshillit drejtues për birësimin e fëmijëve nga aplikantët, raportin e përshtatshmërisë së aplikantit me fëmijën. Me fillimin e procedurës gjyqësore, gjykata vepron sipas kërkesës së aplikantit (apo bashkëshortëve aplikues). Kërkesa për birësim e bërë nga një shtetas shqiptar, bëhet në Gjykatën e vendbanimit të personit që kërkon të birësojë e cila është kompetente.⁷⁰ Ndërsa kërkesa për birësim të cilën e parashtron shtetasi i huaj apo shqiptar që banon jashtë shtetit, paraqitet në gjykatën ku ndodhet vendbanimi i të miturit.⁷¹

Kërkesa për birësim përmban:

- *Të dhëna lidhur me identitetin e aplikantit për birësim ose bashkëshortët aplikues (data dhe vendi i lindjes, arsimi, gjendja civile, numri i martesave, me apo pa fëmijë);*
- *Të dhëna lidhur me Komitetin Shqiptar të Birësimit dhe institucionin e përkujdesjes;*
- *Objektin e kërkesës (birësimin e të miturit);*
- *Bazën ligjore : dispozitat e KF dhe të ligjit nr.9695, datë 19.03.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit";*
- *Gjykatën kompetente të cilës i drejtohet kërkesa;*

Parashtrimin e kërkesës me të gjitha detajet e fazës administrative të procedurës së birësimit aplikuesit kanë të drejtë të paraqesin edhe kërkesën për ndryshimin e emrit të fëmijës e cila vlerësohet nga gjykata. Gjatë kohës kur bëhet hetim gjyqësor, Gjykata verifikon se a janë respektuar gjitha parimet e birësimit, a janë plotësuar kushtet dhe kriteret për birësim si nga ana e aplikuesit ashtu edhe nga ana e fëmijës, ekzistimin e ndalesave apo pengesave për birësim, verifikon procedurën administrative dhe periudhën e provës për të konfirmuar ecurinë e

⁷⁰ Neni 253 Ligji Nr. 9062, datë 08.05.2003, "Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimet i Republikës së Shqipërisë"

⁷¹ Arta Mandro, E drejta familjare, Tiranë 2009, fq.478,479

marrëdhënieve ndërmjet të miturit dhe me aplikuesit për birësim dhe se a janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për kthimin e fëmijës pranë prindërve biologjik.

Moment i rëndësishëm është marrja e pëlqimit nga ana e prindërve biologjik. Gjykata kompetente pëlqimin e prindërve biologjik të fëmijës e merr drejtpërdrejt. Kur personi ka vendbanim ose vendqëndrim në shtet tjetër, mund të japë pëlqimin para agjentit diplomatik apo konsullor, pranë ambasadës ose konsullatës shqiptare. Gjykata është e obliguar të verifikojë nëse pëlqimi është tërhequr.

Gjykata duhet të bëjë kujdes në dhënien e pëlqimeve me nxitim. Pëlqimi i dhënë për birësim nuk duhet të jetë i përgjithshëm por duhet të jetë specifik për një fëmijë konkret dhe për rast konkret të birësimit. Pëlqimi duhet të jepet personalisht. Kështu për birësimin e të miturit duhet të jepet pëlqimi nga të dy prindërit, përveç rasteve kur prindi tjetër ka vdekur, nuk është në gjendje të shpreh pëlqimin e tij, ose i është hequr e drejta prindërore. Në këto raste pëlqimi i njërit prind mjafton. Me kodin për familje janë përcaktuar rastet kur jepet pëlqimi nga autoriteti gjyqësor. Kjo ndodh kur fëmijës i kanë vdekur të dy prindërit, kur atyre iu është hequr zotësia për të vepruar, ose janë të panjohur. Në këto raste gjykata vendos nëse fëmija do të birësohet. Në rastet kur gjatë procedurës së birësimit të një fëmije paraqitet një kërkesë në gjykatë për njohje atësie, procedura e birësimit pezullohet deri në përfundimin e gjykimit për njohje të atësisë.

Pëlqimi dhe mendimi i fëmijës që birësohet- Sipas ligjit shqiptar kur fëmija mbush moshën 10 vjeç duhet të merret mendimi i tij dhe në moshën 12 vjeç kërkohet pëlqimi i tij. Birësimi pa dëshirën dhe pëlqimin e fëmijës nuk mund të lejohet. Respektimi i të drejtave procedurale të fëmijës është i rëndësishëm gjatë procesit të birësimit.⁷²

Pëlqimi i aplikuesit për birësim- Nëse vdes birësuesi pasi ka dhënë pëlqimin para dhënies së vendimit, gjykata mund ta vazhdojë procedurën e gjykimit për përfundimin e birësimit.

Pëlqimi i bashkëshortit të birësuesit- Në rastet kur fëmija birësohet nga vetëm njëri bashkëshort kërkohet edhe dhënia e pëlqimit të bashkëshortit të birësuesit.

⁷² Arta Mandro, E drejta familjare, Tiranë 2009, fq.483,484

Kodi i Familjes parashikon mundësinë e ndërhyrjes në procedurën e birësimit të çdo personi që ka interes të ligjshëm për mbrojtjen e të miturit si dhe të prokurorit. Gjithashtu këto subjekte kanë të drejtë ankese ndaj vendimit të gjykatës. Vendimin e formës së prerë Gjykata ia dërgon zyrës së gjendjes civile për regjistrim, ku e ka regjistrin birësuesi. Birësimi është i përvokueshëm.

4.1.3 Efektet juridike të birësimit

Birësimi i prodhon efektet e tij nga data që vendimi për birësim merr formë të prerë. Birësimi është i përvokueshëm. Gjykata i dërgon vendimin e formës së prerë për regjistrim zyrës së gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar birësuesi. Me birësimin ndërmjet birësuesit dhe gjinisë së tij, nga njëra anë, dhe të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga ana tjetër, lindin të drejta dhe detyra të njëjta me ato që kanë ndërmjet tyre personat që janë gjini. Të drejtat dhe detyrat ndërmjet të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga njëra anë, dhe gjinisë së tij, nga ana tjetër, pushojnë. Kur njëri nga prindërit e të birësuarit është bashkëshort i birësuesit, i birësuari nuk i shkëput lidhjet me këtë prind dhe gjininë e tij.⁷³

⁷³ Arta Mandro , E drejta familjare, familja, fëmijët, martesat, bashkëshortët, Tiranë , 2009
Ligji Nr. 9062, datë 08.05.2003, "Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimet i Republikës së Shqipërisë"
Ligji Nr. 9695, datë 19.03.2007, "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit"
<http://kshb.gov.al/>
neni 18 i ligjit 965/19.3.2007
neni 22 i ligjit 965/19.3.2007

4.2 Adoptimi sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës

Sipas autorit Abdulla Aliu, adoptimi paraqet një rën nga format themelore për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore të paraparë me Ligjin për Familje të Kosovës. Në nenin 160 të LFK potencohet edhe qëllimi i adoptimit i cili ka të bëjë me vendosjen e fëmijës nën kujdesin e personit i cili dëshiron ta marrë fëmijën në përgjegjësi dhe përkujdesje të tij.⁷⁴ Me rastin e themelimit të adoptimit duhet të merret në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës. Adoptimi lejohet kur i shërben edukimit, mirërritjes dhe arsimimit të fëmijës, si dhe kur pritet që mes fëmijëve dhe adoptuesve do të krijohen marrëdhënie sikur prind-fëmijë biologjik. Vendimin për themelimin e adoptimit e nxjerr gjykata kompetente.

Me adoptim zgjidhet familja që do të përkujdeset për fëmijën dhe do ta adoptojë fëmijën. Mënyra apo forma e themelimit të kësaj marrëdhënie është ligjore (artificiale) ngaqë themelohet përmes aktit juridik dhe jo në mënyrë natyrore. Përmes adoptimit përveç që fëmija pa prindër dhe përkujdesje prindërore sigurohet nga një familje që e adopton, edhe familja e cila e merr fëmijën e plotëson nevojën për të pasur fëmijë, pra plotësohen dy interesa të përbashkëta.⁷⁵

Në nenin 163 të LFK theksohet se adoptimi si institut lejohet vetëm kur themelohet në interes të fëmijës.⁷⁶ Instituti i adoptimit themelohet për fëmijët të cilëve u mungon kujdesi prindëror për shkak se prindërit e tyre nuk janë gjallë, prindërit i kanë të panjohur, apo kanë vdekur. Gjithashtu fëmijë pa prind dhe përkujdesje prindërore konsiderohen ata fëmijë prindërit e të cilëve për çfarëdo lloj arsye nuk i kryejnë të drejtat dhe detyrimet prindërore.

⁷⁴ Neni 160 Ligji për Familje i Kosovës, Ligji Nr. 2004/32

⁷⁵ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta Familjare, Prishtinë 2007, fq.249

⁷⁶ Neni 163 Ligji për Familje i Kosovës, Ligji Nr. 2004/32

4.2.1 Kushtet për adoptim

Për themelimin e adoptimit duhet të plotësohen këto kushte: 1) *nevoja për adoptim*, 2) *kushtet lidhur me të adoptuarin*, 3) *kushtet lidhur me adoptuesin dhe* 4) *pëlqimi i prindërve*.⁷⁷

- 1) *Nevoja për adoptim* - kusht themelor i adoptimit është nevoja për adoptim. Për themelimin e adoptimit duhet të ekzistojë arsyeja e cila është e domosdoshme dhe që adoptimi të bëhet në interes të fëmijës. Qëllimi i adoptimit arrihet atëherë kur fëmija është pa përkujdesje prindërore, për arsye se prindërit nuk i ka gjallë, janë të panjohur ose janë zhdukur dhe kur prindërit nuk i ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet prindërore. Kur këto arsye ekzistojnë paraqitet nevoja për adoptim.
- 2) *Kushtet lidhur me të adoptuarin* - Që adoptimi të themelohet fëmija duhet të jetë i mitur, që do të thotë se personat e moshës madhore nuk mund të adoptohen. Sipas nenit 168 të LFK fëmija i moshës 14 vjeçare pëlqimin për adoptim e jep personalisht ndërsa nën këtë moshë nevojitet pëlqimi nga përfaqësuesi i tij ligjor.⁷⁸ Pëlqimin në emër të fëmijës e japin prindërit e tij ose kujdestari. Në legjislacion ekzistojnë edhe disa kufizime për sa i përket të adoptuarit. Sipas nenit 177 të LFK, nuk mund të adoptohet personi në gjini në vijë të drejtë, as vëllai dhe motra.⁷⁹ Gjithashtu as kujdestari nuk mund ta adoptojë fëmijën që kujdeset përderisa zgjat marrëdhënia e kujdestarisë.
- 3) *Kushtet lidhur me adoptuesin* - Edhe adoptuesi duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara me ligj. Adoptuesi duhet të jetë person i moshës madhore dhe me cilësi në ushtrimin me sukses të të drejtave prindërore. Sipas nenit 176 të LFK prindi adoptues duhet të ketë arritur moshën 21 vjet.⁸⁰ Nëse adoptojnë bashkëshortët bashkarisht njëri duhet të ketë 21 vjet dhe tjetri 25 vjet. Nëse adopton vetëm njëri bashkëshort nevojitet pëlqimi i bashkëshortit tjetër. Adoptues nuk mund të jetë: Personi që me vendim gjyqësor i është hequr zotësia e veprimit ose e drejta prindërore, personi për të cilin dyshohet se e keqpërdor adoptimin në dëm të të adoptuarit si dhe do të realizojë përfitime nga

⁷⁷ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta familjare, Prishtinë 2007, fq.250

⁷⁸ Neni 168 i Ligjit për familjen të Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)

⁷⁹ Neni 177 i Ligjit për familjen të Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)

⁸⁰ Neni 176 i Ligjit për familjen të Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)

adoptimi, personi i cili vuan nga sëmundje psiqike të diagnostifikuarose personi që vuan nga ndonjë sëmundje që e vë në rrezik jetën e të adoptuarit.

- 4) *Pëlqimi i prindërve* - Për të qenë i plotëfuqishëm adoptimi kërkohet të jepet pëlqimi nga prindërit. Këtë pëlqim prindërit nuk mund ta japin para se ti mbush fëmija 8 javë, që domethënë se para kësaj kohe nuk mund të themelohet adoptmi.⁸¹

Adoptimi është i plotëfuqishëm edhe në rastet kur prindi e ka dhënë pëlqimin para se të dihen adoptuesit. Pëlqimi i prindit mund të zëvendësohet edhe me vendimin e gjykatës, në rastet kur prindi cënon të drejtat e fëmijës. Zëvendësimi i pëlqimit të prindit do të bëhet edhe në rastet kur ai për 6 muaj e ka braktisur fëmijën dhe nuk i dihet vendqëndrimi.⁸²

⁸¹ Neni 169 i Ligjit për familjen të Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)

⁸² Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta Familjare, Prishtinë 2007, fq.252

4.2.2 Procedura gjyqësore e adoptimit

Procedura e themelimit të adoptimit

Gjatë themelimit të adoptimit ndërmerren një sërë veprimesh procedurale, që nga paraqitja e kërkesës, marrja e informatave dhe dokumenteve përkatëse e deri te sjellja e vendimit përfundimtar. Procedura e themelimit të adoptimit ndahet në: Procedurë paraprake (përgatitore) dhe marrja e vendimit. Procedura paraprake e themelimit të adoptimit ka për qëllim të kryejë përgatitjet për themelimin e adoptimit. Procedura e adoptimit fillon me parashtrimin e kërkesës nga prindërit adoptues.

Fillimi i procedurës

Pas paraqitjes së kërkesës për adoptim, adoptimi do të themelohet nga gjykata. Kërkesa nuk mund të parashtrohet nga përfaqësuesi domethënë parashtrohet personalisht nga adoptuesit. Kërkesa për adoptim i parashtrohet Gjykatës kompetente ku adoptuesit e kanë vendbanimin e tyre të përbashkët, si dhe në territorin e së cilës e ka vendbanimin i adoptuari. Kërkesës duhet t'i bashkangjitet edhe pëlqimi në formë të shkruar i prindërve biologjik të fëmijës, çertifikata e lindjes së fëmijës, si dhe dokumentacioni i nevojshëm për të dëshmuar se adoptimi është në interes të fëmijës si dhe dokumentet me të dhëna për te adoptuarin dhe adoptuesin si dhe kushtet e adoptimit.⁸³ Pas fillimit të procedurës së adoptimit, gjatë procedurës paraprake gjykata e cila zhvillon procedurën për adoptim duhet t'iu ofroj palëve këshilla ligjore për adoptimin si dhe ti njoftojë për efektet ligjore dhe morale të adoptimit. Gjatë kësaj faze gjykata grumbullon mendimet e ekspertëve, nga fusha e shërbimeve sociale, pedagogë, psikologë etj. Sips LFK edhe organi i kujdestarisë sipas detyrës zyrtare duhet të përfshihet në procedurë dhe të ndërmarrë veprime për përgaditjen sa më të mirë të aktit themelimit të adoptimit.⁸⁴

⁸³ Haxhi Gashi, Abdulla Aliu, E drejta familjare, Prishtinë 2007, fq.253

⁸⁴ Neni 184 i Ligjit për familjen të Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)

Refuzimi i kërkesës për adoptim

Në procedurën paraprake gjykata duhet t'i shqyrtojë të gjitha provat dhe faktet e nevojshme që adoptimi të themelohet në bazë të kushteve apo kritereve të përcaktuara me ligj. Nëse gjykata gjatë shqyrtimit të gjithë dokumentacionit konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me ligj ose konstaton se themelimi i adoptimit nuk është i dobishëm për të adoptuarin, do të marrë vendim për refuzimin e kërkesës për adoptim. Pala që i është refuzuar kërkesa ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.⁸⁵

Akti i themelimit të adoptimit

Akti i themelimit të adoptimit apo marrja e vendimit është faza e fundit e procedurës gjyqësore për themelimin e adoptimit. Kjo fazë zhvillohet vetëm kur janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara me ligj për themelimin e adoptimit. Nëse gjykata konstaton se janë plotësuar gjitha kushtet do ta themelojë adoptimin. Gjatë themelimit të adoptimit duhet të jenë të pranishëm adoptuesi, bashkëshorti i tij, prindërit e të adoptuarit, ose kujdestari i tij, dhe gjithashtu nevojitet prania e fëmijës nëse është më i vjetër se 10 vjet. Gjatë themelimit të adoptimit duhet të jepen deklaratat e gjithë pjesëmarrësve. Përmes deklaratave ata shprehin pajtimin për themelimin e adoptimit. Deklaratat shënohen në procesverbalin e gjykatës pranë së cilës themelohet adoptimi. Me përfundimin e procedurës procesverbali nënshkruhet dhe duhet t'u lexohet personave prezent.⁸⁶

Përmbajtja e procesverbalit

Procesverbali i themelimit të adoptimit përmban të dhënat për të gjitha veprimet e marra, për të gjitha informatat e mbledhura nga gjykata dhe për deklaratat dhe marrëveshjet e të adoptuarit dhe prindërve si dhe shpalljen përfundimtare të adoptimit. Procesverbali mbi themelimin e adoptimit përmban mbiemrin e të adoptuarit sipas mbiemrit të palës adoptuese. Çdo ndryshim i emrit të parë, respektivisht shtim i emrit të parë duhet gjithashtu të shënohet.

⁸⁵ Neni 185 i Ligjit për familjen të Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)

⁸⁶ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta Familjare, Prishtinë 2007, fq.255

Procesverbali për themelimin e adoptimit ofron të dhëna për prindërit e të adoptuarit si dhe të dhëna për palën adoptuese. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga të gjithë personat të cilët kanë qenë të involvuar në procesin e adoptimit, si dhe nga përfaqësuesi i gjykatës i cili e ka zhvilluar procedurën. Gjykata është e detyruar të mbajë të gjitha shënimet dhe t'i ruajë dokumentet për personat e adoptuar dhe procesin e adoptimit.⁸⁷

Regjistrimi I adoptimit

Gjykata kompetente ia dërgon menjëherë procesverbalin për themelimin e adoptimit organit kompetent për regjistrim në librin amë të të lindurve, gjithashtu ia dërgon edhe palës adoptuese dhe Organit të Kujdestarisë. Pala adoptuese regjistrohet si prind i të adoptuarit.⁸⁸

⁸⁷ Neni 187 i Ligjit për familjen të Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)

⁸⁸ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta Familjare, Prishtinë 2007, fq.256

4.2.3 Efektet juridike të adoptimit

Nëse fëmija adoptohet nga bashkëshortët ose nëse bashkëshorti e adopton fëmijën e bashkëshortit tjetër, ai fëmijë e fiton statusin ligjor të fëmijës së përbashkët të bashkëshortëve. Në raste tjera, fëmija e fiton statusin ligjor të fëmijës të prindit adoptues. Me përfundimin e adoptimit, marrëdhënia ligjore mes fëmijës dhe pasardhësve të tij dhe të kushërinjve të tij shuhet së bashku me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo. Kërkesat e fëmijës të cilat janë bërë para adoptimit veçanërisht ato që kanë të bëjnë me anuitetet, pensionin për bonjak dhe pagesat tjera periodike që korrespondojnë, nuk do të preken me adoptim, kjo nuk do të zbatohet për kërkesat për mbajtje. Fëmija e merr mbiemrin e personit adoptues sikur të ishte mbiemri i tij. Nëse çifti i martuar adopton fëmijë ose nëse njëri nga bashkëshortët e adopton fëmijën e bashkëshortit tjetër dhe bashkëshortët nuk kanë mbiemër të përbashkët të martesës, ata duhet të përcaktojnë mbiemrin e lindjes së fëmijës duke bërë deklaratë në gjykatë para se të themelohet adoptimi. Gjykata mundet gjatë themelimit të adoptimit:

- 1) Të ndryshojë emrin e parë të fëmijës ose të shtojë një apo më shumë emra të parë nëse kjo është në interes të mirërritjes së fëmijës;*
- 2) Familja e re, me pëlqim të fëmijës vendos ti jap mbiemrin e ri para ose pas mbiemrit të mëparshëm, nëse kjo është në interes të mirërritjes së fëmijës.*

Kur i adoptuari është më i vjetër se dhjetë vjet, pëlqimi i tij kërkohet për ndryshimin e mbiemrit dhe çdo ndryshim të emrit.⁸⁹ Në nenin 13 të Ligjit mbi emrin personal theksohet se ndërrimi i emrit personal gjatë adoptimit bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Familjen.⁹⁰

⁸⁹ Neni 190,191,193 Ligji për Familje i Kosovës, Ligji Nr. 2004/32

⁹⁰ Neni 13 Ligji për emrin personal i Kosovës NR. 02/L-118

4.3 Konventa e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit

Konventa e Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunim për adoptimet jashtë vendit, në nenin 1 të saj parasheh se në rast të adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore duhet "të merren masat mbrojtëse për të siguruar se adoptimet jashtë vendit do të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke i respektuar të gjitha të drejtat e tij themelore të garantuara me të drejtën ndërkombëtare".⁹¹ Në nenin 4 të Konventës së Hagës parashihet se adoptimi brenda sferës së Konventës kryhet vetëm atëherë në rast se autoritetet kompetente të shtetit të origjinës: kanë përcaktuar se fëmija mund të adoptohet dhe kanë vendosur se adoptimi jashtë vendit është në interesin më të lartë të fëmijës etj. Pra adoptimi duhet të themelohet vetëm atëherë kur merret parasysh interesi më i lartë i fëmijës. Ndërsa në nenin 2 është e theksuar se kur zbatohet kjo Konventë edhe atë:

1. *Konventa zbatohet kur një fëmijë, i cili zakonisht banon në një Shtet Kontraktues ("Shteti i origjinës"), është shpërngulur, shpërngulet ose do të shpërngulet në një Shtet tjetër Kontraktues ("Shteti pritës"), ose pas birësimit të tij në Shtetin e origjinës, nga bashkëshortë ose nga një person që banon zakonisht në Shtetin pritës, ose për qëllime të një birësimi të tillë në Shtetin pritës ose në Shtetin e origjinës.*
2. *Konventa mbulon vetëm birësimet që krijojnë një marrëdhënie të përhershme prind-fëmijë.*

Është me rëndësi të ceket Konventa e Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit, (Ligji Nr.8624, datë 15.6.2000 për aderim të Shqipërisë në këtë Konventë). Gjithashtu edhe Republika e Maqedonisë është nënshkruese e Konventës së Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptim jashtë vendit, 20.IX.1995.

Birësimi në kuadrin e Konventës do të bëhet vetëm në rast se autoritetet kompetente të Shtetit pritës:

- *kanë vendosur që prindërit e ardhshëm birësues kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar;*

⁹¹ Neni 1 i Konventës së Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit

- janë siguruar se prindërit e ardhshëm birësues janë këshilluar sipas nevojës; dhe
- kanë vendosur që fëmija është autorizuar ose do të autorizohet për të hyrë dhe për të banuar përgjithmonë në atë Shtet.

Personat që zakonisht banojnë në një shtet Kontraktues dhe që dëshirojnë të birësojnë një fëmijë, zakonisht banues në një shtet tjetër Kontraktues, i drejtohen Autoritetit Qendror të Shtetit ku banojnë zakonisht. Në rast se për Autoritetin Qendror të Shtetit pritës përmbushen kërkesat që aplikuesit kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar, ai përgatit një raport, i cili përfshin informacion mbi identitetin e tyre, të drejtën dhe përshtatshmërinë për të birësuar, mbi biografinë e tyre, mbi familjen dhe gjëndjen shëndetësore, mjedisin shoqëror, arsyet për birësim, mundësinë për të ndërmarrë një birësim jashtë vendit, si dhe karakteristikat e fëmijëve, për të cilët ata do të zgjidhen të kujdesen. Ai transmeton raportin e Autoritetit Qendror Shtetit të origjinës. Sa i përket Shqipërisë, për dallim nga Kosova, ajo është edhe nënshkruese e disa Konventave për të drejtat e fëmijëve dhe adoptimin e tyre. Njohja e një birësimi përfshin njohjen e:

- marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë midis fëmijës dhe prindërve të tij birësues;
- përgjegjësinë prindërore të prindërve birësues ndaj fëmijës;
- ndërprerjen e marrëdhënieve të mëparshme midis fëmijës dhe nënës apo babait të tij, në rast se birësimi ka një pasojë të tillë në Shtetin Kontraktues, kur është bërë.

Në rastin e birësimit që ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore prind- fëmijë, fëmija gëzon në Shtetin pritës dhe në çdo Shtet tjetër Kontraktues ku birësimi njihet, të drejta të barabarta me ato që rrjedhin nga birësimet që kanë pasojë të tillë në secilin Shtet. Paragrafet e mësipërm nuk paragjykojnë zbatimin e çdo dispozite, që është më e favorshme për fëmijën dhe që është në fuqi në Shtetin Kontraktues, i cili pranon birësimin. Kur birësimi i lejuar në Shtetin e origjinës nuk ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë, ai mund të kthehet në një birësim të efektshëm në Shtetin, i cili njeh birësimin në bazë të Konventës:

- në rast se ligji i Shtetit pritës lejon një gjë të tillë, dhe
- në rast se pëlqimet e përmendura në nenin 4, paragrafet c dhe d, janë dhënë për qëllim të një birësimi të tillë.

4.4 Konventa Evropiane për adoptimin e fëmijëve

Kjo Konventë zbatohet për adoptimin e një fëmije, i cili, në kohën kur adoptuesi kërkon ta birësojë atë, nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, nuk është dhe nuk ka qenë i martuar. Kjo Konventë mbulon vetëm institucionet ligjore të adoptimit të cilat krijojnë një marrëdhënie të përhershme prind fëmijësh.

Çdo Shtet Palë do të miratojë masa legislative ose masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar përputhjen e ligjit të tij me dispozitat e kësaj Konvente dhe do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për masat e marra për këtë qëllim. Në nenin 3 të Konventës theksohet se adoptimi është i vlefshëm vetëm nëse është dhënë nga një gjykatë ose një autoritet administrativ.⁹²

Autoriteti kompetent nuk do të lejojë themelimin e adoptimit nëse nuk është i bindur se adoptimi do të jetë në interesin më të mirë të fëmijës. Në secilin rast, autoriteti kompetent do t'i kushtojë vëmendje të veçantë rëndësisë së adoptimit për t'i siguruar fëmijës një shtëpi të qëndrueshme dhe harmonike. Ligji lejon që një fëmijë të adoptohet: nga dy persona të seksit të ndryshëm, të cilët janë të martuar me njëri-tjetrin ose kur ekziston një institucion i tillë, kanë lidhur një partneritet të regjistruar së bashku; dhe nga një person.

Shtetet janë të lira të zgjerojnë objektin e kësaj Konvente për çiftet e të njëjtit seks që janë të martuar me njëri-tjetrin ose që kanë hyrë në një partneritet të regjistruar së bashku. Ata janë gjithashtu të lirë për të zgjeruar objektin e kësaj Konvente për çiftet e seksit të ndryshëm dhe çiftet e të njëjtit seks që jetojnë së bashku në një marrëdhënie të qëndrueshme.

Një fëmijë mund të adoptohet vetëm nëse adoptuesi ka mbushur moshën minimale të përcaktuar me ligj për këtë qëllim, kjo moshë minimale nuk është as më e vogël se 18 e as më shumë se 30 vjeç. Duhet të ketë një diferencë të përshtatshme moshe midis adoptuesit dhe fëmijës, duke pasur parasysh interesat më të mira të fëmijës, mundësisht një diferencë prej të paktën 16 vjetësh.

⁹² Neni 3 i Konventës Evropiane për adoptimin e fëmijëve

Megjithatë, ligji mund të lejojë që kërkesa për moshën minimale ose diferencën e moshës të hiqet në interesin më të mirë të fëmijës:

- *kur adoptuesi është bashkëshorti ose partneri i regjistruar i babait ose nënës së fëmijës;*
- *ose për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme.*

Pas adoptimit, fëmija do të bëhet anëtar i plotë i familjes së adoptuesit dhe do të ketë në lidhje me adoptuesin dhe familjen e tij ose të tyre të njëjtat të drejta dhe detyrime si një fëmijë i adoptuesit prejardhja e të cilit është e vërtetuar ligjërisht. Adoptuesit do të kenë përgjegjësinë prindërore për fëmijën. Adoptimi do të ndërpresë marrëdhëniet juridike ndërmjet fëmijës dhe babait të tij, nënës dhe familjes biologjike.

Shtetet Palë do të lehtësojnë fitimin e shtetësisë së tyre nga një fëmijë i adoptuar nga një prej shtetasve të tyre. Humbja e shtetësisë që mund të rezultojë nga një adoptim do të kushtëzohet me posedimin ose fitimin e një shtetësie tjetër. Në nenin 13 të Konventës potencohet se numri i fëmijëve që mund të adoptohen nga i njëjti adoptues nuk kufizohet me ligj.⁹³ Personi që ka ose mund të ketë një fëmijë, për këtë arsye nuk ndalohet me ligj të adoptojë një fëmijë.

Adoptimi mund të revokohet ose anulohet vetëm me vendim të organit kompetent. Interesat më të mira të fëmijës do të jenë gjithmonë konsiderata kryesore. Adoptimi mund të revokohet vetëm për arsye serioze të lejuara me ligj përpara se fëmija të arrijë moshën madhore. Kërkesa për anulim duhet të bëhet brenda një afati të përcaktuar me ligj. Në rast të procedurave në pritje për përcaktimin e atësisë, ose kur ekziston një procedurë e tillë për vendosjen e amësisë, të nisur nga babai ose nëna e supozuar biologjike, procedurat e adoptimit do të pezullohen, sipas rastit për të pritur rezultatet për procedurat e prindërimit. Autoritetet kompetente do të veprojnë me shpejtësi në këto procedura prindërore. Askush nuk mund të nxjerrë ndonjë përfitim të pahijshëm financiar ose tjetër nga një aktivitet që lidhet me adoptimin e një fëmije.

Shtetet Palë janë të lira të kërkojnë që fëmija të ketë qenë nën kujdesin e adoptuesit përpara se të jepet adoptimi për një periudhë të mjaftueshme për të mundësuar një vlerësim të arsyeshëm

⁹³ Neni 13 i Konventës Evropiane për adoptimin e fëmijëve

nga autoriteti kompetent në lidhje me marrëdhëniet e tyre të ardhshme nëse adoptimi do të jepej. Në këtë kontekst, interesi më i mirë i fëmijës do të jetë konsiderata kryesore.

Fëmija i adoptuar duhet të ketë akses në informacionin e mbajtur nga autoritetet kompetente në lidhje me origjinën e tij/saj. Kur prindërit e tij ose të saj të origjinës kanë të drejtë ligjore për të mos zbuluar identitetin e tyre, ai do t'i mbetet i hapur autoritetit kompetent, në masën e lejuar nga ligji për të përcaktuar nëse duhet të anashkalohet kjo e drejtë dhe të zbulohet informacioni identifikues, duke pasur parasysh rrethanat dhe për të drejtat përkatëse të fëmijës dhe prindërve të tij/saj origjinën. Udhëzimet e duhura mund t'i jepen një fëmije të adoptuar që nuk ka mbushur moshën madhore.⁹⁴

⁹⁴ Konventa Evropiane për Birësimin e Fëmijëve Strasburg, 27.XI.2008

Përfundimi

Pjesa më me interes në një shoqëri janë fëmijët. Edukimi, mirërritja dhe arsimimi i tyre paraqet rëndësi shumë të madhe për shoqërinë. Të gjithë fëmijët meritojnë të rriten dhe edukohen në një familje e cila bën çmos për fëmijën e tij. Mirëpo nuk e kanë të gjithë fëmijët fatin e të qenurit anëtarë i një familje të shëndoshë me prindër dhe përkujdesje prindërore. Pra ka fëmijë të cilët janë të privuar nga jeta familjare për arsye të ndryshme. Këta fëmijë të braktisur pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore kanë nevojë për dashuri, përkujdesje dhe siguri. Në rastet e këtyre fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore si formë apo mënyrë më e përshtatshme për sigurinë e tyre është parë adoptimi. Pa dyshim se adoptimi ka rëndësi edhe për adoptuesit. Ata në këtë mënyrë plotësojnë dëshirat e veta për të qenë prindër dhe për të pasur fëmijë.

Ky institut në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas rregullimit ligjor që ka, kategorizohet në institutet më pak të përpunuara apo të rregulluara me ligj në kuadër të së drejtës familjare. Është më se e nevojshme të bëhen ndryshime dhe plotësime në ligjin për familje sa i përket pjesës për mbrojtjen e fëmijëve dhe sidomos në pjesën e adoptimit si formë më e përshtatshme për mbrojtjen e të gjithë fëmijëve. Instituti i adoptimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullohet me: Ligjin për familjen (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.83/2004) , Ligjin mbi mbrojtjen sociale (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.21/2006), Ligjin mbi trashëgiminë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 47/1996), Ligjin për emrin personal (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 08/1995), Ligjin mbi evidencën amë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 08/1995), Ligjin mbi të drejtën ndërkombëtare private (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 87/2007), Ligjin mbi shtetësinë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.45/2004).

Gjithashtu edhe përpilimi i një ligji të veçantë është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për rregullimin e institutit të adoptimit. Poashtu kemi jotransparencë të organeve shtetërore sa i përket adoptimit, nuk ekziston një raport i adoptimit në Entin Shtetëror Statistikor. Edhe Qendrat për Punë sociale nuk japin informata sa i përket fëmijëve të adoptuar ngaqë shumica e adoptuesve dhe prindërve biologjik dëshirojnë të fshihet fakti i adoptimit. Është e nevojshme që ne Republikën e Maqedonisë së veriut të hapet Agjencioni për ndërmjetësim rreth adoptimit, duke pasur rolin e një organizate të licencuar dhe miratuar nga organet e vendit.

Kjo veprimtari e Agjencionit duhet të rregullohet me ligj. Roli i Agjencionit do të vinte në shprehje në momentin e ndërmjetsimit tek adoptimi ndërkombëtar. Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut e rregullon vetëm me disa nene institutin e adoptimit pavarësisht rëndësisë që ka ky institut. Andaj është më se i nevojshëm hartimi i një ligji të veçantë.

Për sa i përket aspektit krahasues së institutit të adoptimit me shtetet e rajonit ekzistojnë dallime dhe ngjashmëri në pjesën e rregullimit të këtij instituti. Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar Konventën Evropiane për adoptimin e fëmijëve, gjithashtu edhe Shqipëria është nënshkruese e disa Konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe adoptimin e tyre, është me rëndësi të ceket Konventa e Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit, (Ligji Nr.8624, datë 15.6.2000 për aderim të Shqipërisë në këtë Konventë), Konventa Evropiane për marrëdhënie me fëmijët (Ligji Nr.9359 datë 31.03.2005)etj. Për dallim nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, Kosova nuk është nënshkruese e Konventave ndërkombëtare për adoptimin e fëmijëve. Në legjislacionin e RMV-së dhe të Kosovës përdoret termi “i adoptuar” ndërkaj në legjislacionin e Shqipërisë përdoret termi “ i birësuar”.

Gjithashtu në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Shqipëri mosha kur fëmija mund të shpreh pëlqimin e tij për adoptim është e njejtë, kjo moshë është 12 vjet. Ndërsa në Kosovë mosha kur fëmija mund të shpreh pëlqimin e tij për adoptim dallon nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, kjo moshë është 14 vjet. Sipas disa të dhënave nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2021, 118 fëmijë në vend presin të adoptohen, ndërsa në regjistrin e adoptuesve të mundshëm janë regjistruar 280 adoptues potencial, prej të cilëve 192 janë shtetas të Maqedonisë, ndërsa 88 të tjerët janë shtetas të huaj. Numri i fëmijëve që presin të adoptohen është dukshëm më i ulët se sa numri i adoptuesve potencialë që presin të adoptojnë fëmijë.

Rekomandime

Në kuadër të këtij punimi në lidhje me adoptimin si formë më e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijëve pa prind dhe pa përkujdesje prindërore, si rekomandime për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve janë:

- Përpilimi i një ligji të veçantë sa i përket adoptimit të fëmijëve pasi që ky institut rregullohet në kuadër të së drejtës familjare vetëm me disa nene.
- Themelimin e Agjencisë për ndërmjetsim për adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve pa prind dhe pa përkujdesje prindërore.
- Të jepen të dhëna për adoptimin e fëmijëve në entin statistikor shtetëror, transparencë e organeve shtetërore.
- Informimi sa më i gjërë i popullit nga organet e shtetit për institutin e adoptimit, kushtet, procedurat si dhe rëndësinë që ka ky institut si formë më e përshtatshme për strehimin e fëmijëve të braktisur.
- Nëse nuk mund të arrijmë dëri tek përpilimi i ligjit të veçantë për adoptimin, të mund të bëjmë ndryshim në ligjin për familje, të rrisim numrin e neneve të cilat rregullojnë këtë institut.

Bibliografia

1. LIBRA:

- *Arta Mandro , E drejta familjare , Tiranë, 2009*
- *Asllan Bilalli , Bedri Bahtiri, E drejta Romake, Prishtinë ,2015*
- *Abdulla Aliu , Haxhi Gashi , E drejta Familjare , Prishtinë 2007*
- *Arta Mandro , E drejta Romake , Tiranë 2007*
- *Ken Dhima , E drejta Romake , Tiranë, 2007*
- *Emine Zendeli , Arta Selmani , Dejan Mickoviq , Angel Ristov , E drejta Familjare , Tetovë 2020*
- *Dejan Mickoviq , Angel Ristov , Semejno Pravo (E drejta Familjare) ,Shkup 2015*
- *D-r Kiril Çavdar , Komentari na zakonot za semejstvo (so sudska praktika, obrasci za prakticka primena, predmeten registar i pridruzni propisi), Shkup 1998*
- *Hamdi Podvorica, E drejta Familjare, Prishtinë, 2005*

2. KONVENTA, LIGJE, UDHËZIME, RREGULLORE, ARTIKUJ

- *Konventa Evropiane për adoptimin e fëmijëve*
- *Konventa e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit*
- *Konventa mbi të drejtat e fëmijës, 20.11.1989*
- *Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989*
- *Ligji për familjen ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 153/2014)*
- *Ligji për Familje i Kosovës, Ligji Nr. 2004/32*
- *Ligji Nr. 9062, datë 08.05.2003, "Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimet i Republikës së Shqipërisë"*
- *Ligji Nr. 9695, datë 19.03.2007, "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit"*
- *Ligji për Trashëgimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut*
- *Ligji për emrin personal i Kosovës NR. 02/L-118*

- *Ligji mbi shtetësinë i Republikës së Maqedonisë së Veriut Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.45/04, 07.07.2004*
- *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut Numër 08-4642/1*
 - *Rregulloren për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes elektronike të adoptuesve Nr. 10,*
 - *datë: 25.01.2011 e ndryshuar me Rregulloren Nr.10-2831/3, datë 08.05.2012,*
 - *Rregullorja për mënyrën e mbajtjes së evidencës për personat e adoptuar dhe për dokumentet e nevojshme për adoptim*
- *Arta Selmani Çështje të adoptimit në Maqedoni – RSHSL, Konferenca 2008*

3. BURIME NGA INTERNETI

- https://penelope.uchicago.edu/Thayer/E/Roman/Texts/secondary/SMIGRA*/Adoptio.html
- <https://travel.state.gov/content/travel/en/Intercountry-Adoption/Adoption-Process/how-to-adopt/adoption-of-children-from-countries-sharia-law.html>
- <https://www.learnreligions.com/adopting-a-child-in-islam-2003804>
- <https://www.jurist.org/commentary/2012/11/faisal-kutty-adoption-kafalah/>
- https://www.mtsp.gov.mk/te-drejta-sherbime-dhe-masa-nga-mbrojtja-sociale-ns_article-adoptimi-i-femijes.nspX
- <https://akademik.mk/servisni-informacii/postapka-za-posvojuvane-3/>
- <https://zenskimagazin.mk/vo-makedonija-118-deca-chekaat-da-bidat-posvoeni-iako-interesot-za-posvojuvanje-e-dvojno-pogolem>
- <http://kshb.gov.al/>
- <http://www.njohliqjin.al/familja/biresimi/>
- <https://vlada.mk/node/15076?ln=sq>
- <http://ustavensud.mk/?p=10475>
- <http://ustavensud.mk/?p=21927>